



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 25 SHKURT 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
25. FEBRUARA 2010. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2010**

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 25 SHKURT 2010

E enjte, 25 shkurt 2010, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj në sallë janë 85 deputetë që do të thotë janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i paraqet rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Ndërkohë, në pajtim me Rregullën 23.2 të Rregullores së Punës, Grupi Parlamentar për Integrim dhe Grupi Parlamentar i SLS-së kanë bërë propozim me shkrim për emërimin e deputetëve të këtyre grupeve për anëtarë në komisionet parlamentare. Andaj propozoj që kjo të radhitet në pikën e fundit të rendit të ditës për seancën e sotshme plenare.

Lus deputetët që me ngritje dore të miratojnë këtë propozim. Kush është “për”? Faleminderit, shumica janë. A ka “kundër”? Nuk ka. Abstenim? Një. Faleminderit! Miratohet rendi i ditës.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, janë lajmëruar tre deputetë. Deputetja Drita Kadriu e ka kërkuar fjalën.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Me qenë se në Mitrovicë po shënohet java e minatorëve, me lejen tuaj kisha paraqitur një mocion para Kuvendit.

KRYETARI: Ju e dini se 2 minuta keni kohë për këto çështje.

DRITA KADRIU: faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kuadër të manifestimit tradicional - Java e minatorit, në qytetin e Mitrovicës po zhvillohen një varg aktivitete. Me këtë rast, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ua përcjellim urimet më të sinqerta, të nderuar minatorë.

Greva e minatorëve të Trepçës si një moment i ri në vazhden e rezistencës dhe të përpjekjeve tona për liri, në të njëjtën kohë reflektoi pozitivisht edhe në shumë aspekte që lidhen me shoqërinë tonë.

Në vitin 1989 në Kosovë u intensifikua dhuna dhe brutaliteti nga regjimi serb. Ndërkaq, sakrifica e minatorëve forcoi si asnjëherë më parë solidaritetin e popullit tonë anekënd trojeve etnike. E gjithë kjo kishte zhvilluar ndjenjën e rezistencës ndaj robërisë që po bëhej çdo ditë e më e ashpër dhe fillimin e një lëvizje për liri, e cila do të kulmonte me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Viti 1989, vit i ndryshimeve të mëdha, për shumë popuj të Evropës ngjalli edhe shpresat për një të ardhme më të mirë dhe avancim të statusit politik të shqiptarëve të Kosovës. Në këtë kuadër, greva e minatorëve të Trepçës me jehonën e saj të bujshme me sukses të madh arriti të sensibilizojë opinionin demokratik liridashës botëror.

Të nderuar kolegë,

Të dhënat e para për ekzistimin e Trepçës datojnë që nga viti 1303, për të kaluar nëpër krahura historike të papara deri më sot. Sot në ndërmarrjen Trepça punojnë 1341 punëtorë të rregullt....

KRYETARI: Faleminderit! Edhe një minutë, por shpejtoni pak!

DRITA KADRIU: ...ndërsa 4500 punëtorë marrin pensione të ndryshme dhe asistencë sociale. Edhe pse aktualisht Trepça ndodhet në pozitë të vështirë, si pasojë e problemeve të grumbulluara për vite të tëra, sot në Trepçë ka një mobilizim të përgjithshëm për të sanuar gjendjen në të cilën ekziston. Në vitin 2009 për herë të parë ka një rritje prej 29% të prodhimit në minierë, si dhe zvogëlim të shpenzimeve deri në 25%. Kjo jep shpresë se në një të ardhme të afërt Trepça do të bëhet një ndërmarrje shumë e suksesshme.

Të nderuar minatorë, në festën tuaj dhe tonën, në manifestimin tradicional të minatorëve kujtojmë në pika të shkurta historinë e gjatë e të lavdishme.

Me këtë rast, nga Kuvendi ju dëshirojmë shëndet dhe punë të mbarë në rritjen e prodhimit dhe në kontributin tuaj në zhvillimin e vendit. Me fat! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe ne ju dëshirojmë fat minatorëve!

Tani është radha e deputetëve të pavarur. Bujar Dugolli e ka fjalën. Dy minuta i ke.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë sot kam dalë këtu të inicioj një çështje e cila është preokupuese për tërë qytetarët e Kosovës. Ju e dini që më 10 shkurt të vitit 2007 në një protestë paqësore të lëvizjes “Vetëvendosje” u vranë dy qytetarë dhe u plagosën mbi 80. Nga një hetim ndërkombëtarë rezultoi që fajtorë për këtë ngjarje ishin Policia rumune. Pasi që u vërtetua se kush ishin vrasësit, ende vazhdon një proces që me të drejtë vlerësohet si proces politikë ndaj liderit të lëvizjes “Vetëvendosje”, Albin Kurtit. Konsideroj që kjo është e padrejtë dhe duke u bërë apel edhe juve si deputetë, grupeve parlamentare dhe duke respektuar edhe votën dhe zërin e votuesve të qytetarëve të Kosovës, konsideroj që kjo çështje duhet të futet në rend të dite dhe të diskutohet si çështje e rëndësisë së veçantë, qoftë në këtë seancë ose në seancën vijuese. Unë për këtë çështje i kam bërë dy pyetje edhe ministres së Drejtësisë, por konsideroj se në kapacitetet e ministres jam i bindur që nuk do të ketë mundësi të japë ndonjë përgjigje të cilën e kërkojnë qytetarët e Kosovës. Prandaj, është në interes të vendit që kjo çështje të diskutohet në Kuvend, si rezultat i diskutimit të dalë një rezolutë e cila do të orientonte aty ku është problemi dhe do t’i dënonte sulmet e policisë rumune ndaj qytetarëve të Kosovës, njëkohësisht do të kërkonte para drejtësisë ndërkombëtare që këta të dalin para drejtësisë, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare për krimet që i kanë bërë ndaj protestuesve paqësorë.

Së treti, kërkojmë nga Ministria e Punëve të Brendshme të heqë atë kallëzim penal që gjoja është dëmtuar nga kjo lëvizje dhe nga këto protesta.

Dhe, së katërti, në Kosovë të mos ndodhin procese politike për asnjë njeri dhe as për liderin e “Vetëvendosjes”, zotin Albin Kurti. Kërkoj që grupet parlamentare...

KRYETARI: Faleminderit!

Megjithatë, ne thirrëmi në demokracinë parlamentare. Ju e dini cili është roli i deputetëve sipas demokracisë parlamentare të pavarur dhe cili është ndikimi i tyre në demokraci. Më së miri e sqaron këtë çështje fjalori politik i Oksfordit dhe praktika parlamentare britanike.

Po, dua të them që si qytetarë mund të kemi mendime të ndryshme, po si institucion ligjvënës jemi të obliguar të respektojmë ndarjen e pushteteve që ekziston në të gjitha vendet demokratike dhe mendoj që kjo duhet të respektohet. Ne s’mund ta paragjykojmë vendimin e gjykatës, mund të mos pajtohemi edhe me këtë veprim të deritashëm po, realisht, ne vazhdojmë procedimin sipas rendit të ditës që e keni marrë.

Para se të vazhdojmë, e ka një kërkesë edhe ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Idriz Vehapi.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Zoti kryeministër, Kabinet qeveritar, deputetë,

Kërkoj që pika e katërt e rendit të ditës - Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht të tërhiqet nga rendi i ditës për arsye se ky projektligj është proceduar në Kuvend në vitin 2007, pastaj për shkak të fushës që është mjaftë komplekse dhe për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që bëhen në këtë fushë, kemi menduar që edhe në

konsulta me Komisionin Parlamentar për Bujqësi, ky ligj ka nevojë të plotësohet dhe të ndryshohet më tej. Prandaj, kisha kërkuar që ky projektligj të tërhiqet nga rendi i ditës për seancën e sotme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi edhe rekomandimi i komisionit është që të tërhiqet nga rendi i ditës, po votojmë për tërheqjen e këtij ligji.

Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Zoti kryetar,

Ministri ndoshta nuk e ka kuptuar, por ky projektligj duhet të tërhiqet nga procedura e mëtejme me votim në Kuvend dhe i kthehet Qeverisë për t'u rihartuar. Ndoshta këtu këtë qëllim e ka pasur ministri dhe për të marrë këtë rrugë, ky projektligj në bazë të Rregullores duhet një votë formale e Kuvendit, për atë është qitë si pikë e rendit të ditës, që me votë formale të Kuvendit ky projektligj të tërhiqet dhe Ministria ta rihartojë ose ripunojë ose plotësojë këtë ligj dhe ta kthejë pastaj me procedurë të rregullt.

KRYETARI: Faleminderit! Kur vijmë te kjo pikë e rendit të ditës, e heqim dhe ia kthejmë Qeverisë për ta ripunuar. A jeni dakord?

Vazhdojmë me pikën e parë:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 11 shkurtë 2010

Pyes, nëse ka vërejtje në këtë procesverbal?

Pasi që nuk ka, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 11 shkurt 2010.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Po, para se të fillojmë leximin dhe parashtrimin e pyetjeve, ju njoftoj se ministri i Ministrisë për Tregti, Industri nuk është prezent në seancë dhe ka kërkuar që ne ta mirëkuptojmë për mos prezencën e tij. Kjo ishte për njoftimin tuaj.

Vazhdojmë me pyetjen e parë.

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, e keni fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në hapjen e fushatës elektorale në Gjakovë, në tetor të vitit të kaluar, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ka premtuar hapjen e Universitetit të tretë publik në Gjakovë.

Pra, pyes kryeministrin Thaçi, kur do të hapet Universiteti publik në Gjakovë?
Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar, Krasniqi,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
E nderuara deputete Sylja,

Arsimi ka qenë, është dhe do të mbetet prioriteti kryesor i Qeverisë së Republikës së Kosovës sepse është jetike që të investohet në edukim dhe jemi shumë të vëmendshëm dhe të bindur se duke investuar në edukim, ne po investojmë në të ardhmen tonë të sigurt, në zhvillimin ekonomik, por edhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Dua të potencoj, pasi që e përmendët edhe çështjen e arsimit, por edhe pyetjen tuaj konkrete, se nga themelimi i Qeverisë, i këtij kabineti qeveritar që udhëheq unë, ka ndodhur rritja e pagave për gjithë punëtorët universitar 100%, ka ndodhur rritja e pagave deri 47% për gjithë punëtorët e arsimit të shkollave të mesme dhe fillore në bazë të gradimit, por edhe në të njëjtën kohë ju e dini se është marrë vendimi dhe janë ndarë mjetet financiare dhe ka filluar konkretizimi i projektit për hapjen e universitetit të dytë publik në Republikën e Kosovës atë të Prizrenit, që do të fillojë punën më një 1 tetor, me numrin prej 5000 studentësh, me vitin e parë gratis për studentët. Ndërsa, në kuadër të Universitetit publik të Prizrenit është planifikuar për fazën fillestare edhe hapja e degëve të ndryshme në Gjakovë dhe Pejë, ndërsa në vitet e ardhshme, pra në dy vitet e ardhshme, është planifikuar që të hapen edhe universitete tjera. Jemi në fazën finale të projektit për fillimin e hapjes së Universitetit Evropian në Mitrovicë, por me përkushtime të sigurt edhe për hapjen e universitetit publik edhe në Gjilan, Ferizaj, Gjakovë dhe Pejë.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?
Fjala, deputetes Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!
Kryeministër, pyetja shtesë e imja është: - Kur do të hapet Universiteti i tretë publik në Gjakovë? Apo edhe kjo ka qenë një gabim teknik.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Në fakt, Gjakova nuk ka universitet, Kosova e ka një universitet publik, Universitetin e Prishtinës. Është vendimi për hapjen e universitetit të dytë publik në Republikën e Kosovës, atë të Prizrenit dhe kjo çështje është e kryer, dhe do të jetë universiteti i tretë në Republikën e Kosovës dhe jo universiteti i tretë në Gjakovë. Kështu që jam i zotuar dhe kjo gjë do të ndodhë. E përmenda, faza fillestare është e hapja e degëve të Universitetit të Prizrenit në Gjakovë dhe në Pejë dhe pastaj angazhimet tona shtesë, angazhimet tona shtetërore me përgatitjen e projekteve të rëndësishme, siç jemi përgatitur për Prizrenin, me mbulesë në kuptimin edhe financiar, edhe kadrovik, edhe profesional, edhe të interesit ekonomik, duke menduar gjithmonë për të ardhmen. Prandaj, do të hapen universitetet edhe në Gjakovë, edhe në Pejë, edhe

Gjilan, edhe në Ferizaj. Por, tash për tash, në agjendën time aktuale është hapja e Universitetit publik në Prizren, gjë që projekti është duke shkuar shumë mirë, kemi edhe përkrahje ndërkombëtare, do të silltet edhe eksperiencia ndërkombëtare dhe hapja e Universitetit Evropian në qytetin e Mitrovicës.

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Deputetja Rita Hajzeraj, nuk është këtu po më duket, ka një seri pyetjesh.

Vazhdojmë, deputetja Dritë Maliqi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, ministri nuk është këtu, edhe ky është jashtë. Doni ta parashtroni pyetjen? Regjia, fjalën deputetes Dritë Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Meqë aktuale ishte çështja e universiteteve, këtë pyetje që e kam përgatitur ta parashtroj, është e vërtetë, do me thënë, se është për ministrin e Arsimit. Mirëpo, unë do ta parashtroj pyetjen edhe e lus kryeministrin, në qoftë se ka mundësi t'i përgjigjet, varet në qoftë se ai ka mundësi.

I nderuari zoti ministër,

Edhe unë e kam çështjen e Gjilanit, kam pyetjen pse nuk po e ndërtoni një universitet, kur dihet se Gjilani ka në barrë studentët si nga Presheva, Medvegja, Bujanovci, Vitia e Dardana.

Zoti ministër,

Çka i mungon Gjilanit ta ketë një universitet? Ne ju kuptojmë se edhe Prizrenit, edhe Pejës i nevojitet, por pse të mos ketë edhe në Gjilan? Në të ardhmen, ne e dimë që po ndërtohet autostrada Prishtinë – Prizren. Shtroj pyetjen, e për Gjilanin

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ne nuk jemi këtu si qeveri që të punojmë vetëm për një qytet kundër qytetit tjetër. Natyrisht, Qeveria ka prioritetet e veta dhe ju i dini prioritetet që i kemi proklamuar para të gjithë qytetarëve dhe para juve, të nderuar kuvendarë. Aktualisht, pasi që u hapë çështja e universiteteve nëpër krejt qytetet e Kosovës, aktualisht prioritet numër një është hapja e Universitetit të Prizrenit dhe ky është vendim do të shkojë deri në fund, me gjithë investimet e mundshme. Kjo punë është e kryer. I nderuar zoti Kryeziu, faleminderit për mbështetje dhe gjithë deputetët, edhe zoti Zafir Berisha dhe të tjerë deputetë.

Por, në të njëjtën kohë do të vazhdojmë me punën e pakursyer për hapjen e Universitetit Evropian në Mitrovicë. Hapja e universiteteve të reja nuk duhet të jetë diçka që na ndanë në parti, regjione apo qytete. Përkundrazi, është ajo e cila duhet të na afrojë dhe t'i japim mbështetje të plotë investimit në edukim. Prizrenit i ka munguar universiteti dhe kjo po ndodh, kjo duhet të na gëzojë të gjithëve dhe faleminderit për mbështetjen e plotë që e keni dhënë.

Gjilani ka qenë, është dhe do të mbetet prioritet, por nuk dëshiroj tash, se nuk e kemi këtu zotin Fatmir Regjepi që të involvohet në procese elektorale, pa të keq e them. Pas hapjes

së Universitetit të Prizrenit, atij Evropian në Mitrovicë, do të vazhdohet me agjendën tonë. E përmenda, Gjakova dhe Peja do t'i kenë degët e Universitetit të Prizrenit dhe do të vazhdohet me projekte për hapjen e universiteteve në Gjiilan edhe Ferizaj. Tash edhe Ismet Beqiri po e lyp në Vranjevc edhe një universitet, por nuk mund të hapim në çdo lagje universitete.

Prandaj, nëse kërkoni këto përkushtime, ju them shumë hapur, edhe për punëtorët e arsimit, edhe për hapjen e universiteteve nuk do të kursejmë, investimin në edukim nuk do ta kursejmë, sepse është në interesin e të gjithëve. Dua të përsërisë edhe një herë, rej ardhjes në Qeveri, prej ardhjes në Qeveri të këtij kabineti, të këtyre njerëzve që e udhëheqin Qeverinë, ka ndodhur rritja e pagave në Universitetin e Prishtinës 100%, deri 47% të punëtorëve të arsimit të mesëm dhe fillor dhe jemi zotuar për rritjen 100% të pagave për punëtorët e arsimit fillor, të mesëm...

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni kryeministrit fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,
Ne së bashku do të shkojmë të vejmë gurthemelin e Universitetit në Gjiilan. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Ke pyetje shtesë deputete? Një minutë e ke, urdhëro merre fjalën!

DRITA MALIQI: Faleminderit!
Faleminderit shumë, e mirëpres do me thënë, propozimin që po ma realizon kryeministri për ta ndërtuar një universitet në Gjiilan. Faleminderit shumë, zoti kryeministër! Pres, kërkoj dhe a ka mundësi edhe datën, muajin me arsyetimin se ju, i nderuari zoti kryeministër, prioritet për ndërtimin e universiteteve po u jepni vendeve prej nga vini vetë ju, jo prej nga vijmë ne, një pakicë do me thënë, kështu që ju kërkoj, zoti kryeministër, që sa më shpejtë të ndërtoni edhe buxhete që po vijnë nga jashtë, të investoni edhe në qytetin e bukur të Gjiilanit, sepse Gjiilani është një regjion shumë i gjerë dhe ka shumë të rinj të cilët nuk kanë edhe kushte të vijnë mësimet, sepse po ju mungon edhe autostrada për udhëtim, po e kanë shumë vështirë për të udhëtuar, po ju mungon edhe rruga e trenit, që e keni premtuar, ashtu edhe aeroporti, që e keni premtuar, ju lutem, kështu që ju faleminderit, në qoftë se keni mundësinë ...

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,
Njeriu e ka një vendlindje dhe ndihet gjithmonë krenar për vendlindjen e vet. Vendlindja ime është Kosova dhe unë investoj në gjithë Kosovën, jo vetëm në lagjen time apo në vendin ku kam lindur. Unë nuk kam lindur në Prizren, por investoj dhe do të vazhdoj të investoj shumë fuqishëm si në Prizren, si në çdo pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Unë e njoh rëndësinë e Gjiilanit shumë mirë. Prandaj, investimet nuk do të ndalen qoftë në infrastrukturë, qoftë në aspektet tjera, qoftë për hapjen e Universitetit publik në qytetin e Gjiilanit. Je duke kërkuar datën, kohën dhe muajin. Unë e di se

qytetarët e Gjilanit i besojnë premtimit tim dhe kjo do të ndodhë. Ata e dinë datën, e di edhe unë dhe ata i besojnë premtimit tim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Unë po ju kujtoj që arsimi i mesëm dhe i lartë ka nevojë për ngritjen e cilësisë dhe të kualitetit, në rend të parë. Dhe, në rend të dytë, ju përkujtoj se Kosova ka vetëm 11 mijë km² dhe jo bashkë tamam 11 mijë km².

Vazhdojmë me pyetjen. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Ministri ka paralajmërua që s'është këtu, nëse doni ta lexoni pyetjen, mund ta lexoni. Regjia, fjalën deputetes!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Me qenë se pyetja ime drejtuar ministrit Lutfi Zharku po bartet prej seancës së kaluar, mendoj se ndoshta nuk do të kem të drejtë ta shtymë më tutje, prandaj do ta lexoj.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, gjatë vitit 2009 në Kosovë janë regjistruar mbi 7200 ndërmarrje të reja, kurse janë shuar ose kanë ndërprerë aktivitetin e tyre rreth 1000 ndërmarrje. Derisa sipas raportit të Bankës Botërore, të quajtur bashkëbiznes, në vitin 2010 Kosova radhitet në vendin e 113-të nga 180 vende të përfshira në hulumtim, del se në Kosovë nuk është edhe aq lehtë të bëhet biznes. Prandaj, pyetja e parashtruar është: - Zoti ministër, në Ministrinë tuaj a është bërë ndonjë analizë se cilat janë shkaqet që kanë ndikuar në shuarjen e këtyre ...

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Shkumbin Demaliaj, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet, mund ta bëni pyetjen.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Angazhimet e kryeministrit për një qeverisje efikase deri më tani po thuaj se plotësisht kanë dështuar. Kjo reflekton edhe me vetë kapacitetet e tij menaxhuese në Qeverinë e tij në administratën shtetërore. Është viti i tretë i qeverisjes nga kjo qeverisje në Kosovë edhe po thuaj se në administratën shtetërore të Kosovës, kryesisht te shërbyesit e lartë civilë 99.9% janë ushtrues detyre. E kisha lutur kryeministrin e Kosovës të na tregojë sa sekretarë permanentë i ka në ministritë dhe në Qeverinë të cilin ai e drejton dhe sa ushtrues detyre? Është viti i tretë që administrata shtetërore gjendet në këtë mjerim. Kisha lutur kryeministrin të na tregojë sa janë sekretarë permanentë, sa janë ushtrues detyre të sekretarëve permanentë.

KRYETARI: Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar Demaliaj për pyetjen tuaj!

Unë nuk do t'iu kisha përgjigjur opinionit tuaj për qeverinë, se janë qytetarët ata që e vlerësojnë punën e Qeverisë me opinionin e tyre dhe besimin e tyre. Ndërsa, opinionin juaj personal është çështje e përkatësisë edhe partiake tuajën, edhe e përcaktimit, natyrisht, të

angazhimeve tuaja. Por, dua të theksoj se në çështjen e sekretarëve të përhershëm, për shkak të legjislacionit në fuqi, kanë ndodhur lëshime edhe për shkak të mosfunksionimit të Komisionit për Emërime të Larta publike. Si Qeveri, ne kemi bërë përpjekje për rregullimin e këtij vakumi apo boshllëku edhe mendoj se këto çështje do të rregullohen përfundimisht me miratimin e Ligjit për Qeverinë, që e kemi sjellë në Kuvend, por ju i dini arsyet e shtyrjes për shkak të diskutimeve që janë prezantuar në Kuvend. Unë do të angazhohem personalisht edhe për përshpejtimin e procedimit të këtij ligji. Prandaj, sa më shpejtë që ky ligj të procedohet, të gjitha çështjet do të rregullohen dhe këto lëshime janë si rezultat i mos nxjerrjes së Ligjit për Qeverinë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ligjin e kemi sjellë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?
Regjia, fjalën deputetit.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Pa tjetër, zoti kryetar, unë e di se gjithë deputetët kanë ardhur me përkatësi politike këtu, sistemet tjera kanë dështuar. Por, mua më interesoi, sa është e rëndë shkelja e administratës shtetërore? Ne vazhdimisht kemi kërkuar që të aprovohet Ligji për administratën shtetërore. Kryeministri bashkë me Qeverinë e tij e ka futur administratën shtetërore komplet nën kontrollin e tij, prej portierit e deri te ushtruesi i detyrës. Askund në legjislacionin e Kosovës nuk ekziston, as në rregullore tjera, se duhet të ketë ushtrues detyre të sekretarëve permanentë. Çka ka shpikur kryeministri, e dinë ky, vetëm tregomë me cilën dispozitë është e rregulluar, se duhet të ketë ushtrues detyre të sekretarit permanent me përvojë 3 vjet në punë ushtrues detyre. Unë i kërkoj falje kryeministrit në qoftë se ky ka gjetur një dispozitë ku mund të ketë ushtrues detyre të sekretarit permanent, edhe kjo është viti i tretë i qeverisjes.

Përkatësia ime partiake është e imja, është e drejtë e imja dhe e secilit qytetarë, qytetar i Kosovës jam edhe unë....

KRYETARI: Faleminderit, shumë!
Fjalën, kryeministrit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Demaliaj,
Përsëri dua të theksoj se e gjithë kjo çështje do të rregullohet me kalimin e ligjit në Kuvend, të Ligjit për Qeverinë. Me kalimin e ligjit në Kuvend, të Ligjit për Qeverinë, këto çështje rregullohet. Prandaj, ne jemi peng të mos aprovimit të këtij ligji, që është kushtëzuar me kalimin e Ligjit për deputetë. Ndërsa, sa iu përket përkatësive partiake, unë e respektoj përkatësinë tuaj politike, të gjithë deputetët kanë ardhur me përkatësinë e tyre politike, por pak i kanë ndërruar.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. A doni ta lexoni pyetjen, ministri nuk është këtu.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do t'i drejtohem ministrit të Arsimit, zotit Enver Hoxhaj, përkundër asaj që ai nuk ndodhet këtu, por ai sigurisht do të më dëgjojë dhe përgjigjen dua të ma japë në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Komuniteteve.

Zoti ministër,

Në Raportin e progresit të Komisionit Evropian, në kapitullin ku flitet për të drejtat e komuniteteve ekziston konstatimi se sistemi kosovar i arsimit nuk ofron programe mësimore të përshtatura për komunitetin romë dhe goranë. Është e njohur për institucionet e Kosovës se komuniteti goranë në komunën e Dragashit zhvillon procesin mësimor me plan-programe të Qeverisë serbe. Është e drejtë e secilit komunitet të përcaktohet se cilën gjuhë e përvetëson si gjuhë amtare. Por, nuk arsyetohet me asgjë që edhe ...

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Deputete, e keni fjalën! Kujdesu për kohën!

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, kryetar!

Ligji për konfliktin administrativ është me rëndësi të veçantë dhe shumë i nevojshëm në Kosovë. Mungesa e këtij ligji ka për pasojë mungesën e mbrojtjes gjyqësore të qytetarëve, të cilëve u shkelen të drejtat në procedurën administrative me vendim përfundimtar të organit administrativ të shkallës së dytë. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij Ligji për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve kur i shkelen të drejtat si palë në procedurën administrative dhe nevojën e madhe që të mbrohen edhe ato të drejta në procedurën gjyqësore, që duhet të përcaktohen me Ligjin për konfliktin administrativ, ministrin e Administratës Publike e pyes: - Kur do të procedohet ky ligj për miratim në Kuvendin e Kosovës?

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

E nderuar deputete dhe profesoreshë, zonja Dauti,

Ju falënderoj për pyetjen dhe dëshiroj që të theksoj se tanimë po kompletohet korniza ligjore për administratën publike. Mua më vjen keq që s'është zoti Demaliaj, sepse kisha një përgjigje shtesë për të, për shkak se me Projektligjin për Qeverinë dhe Projektligjin për shërbimin civil është rregulluar shumë mirë mënyra e zgjedhjes së sekretarëve permanentë dhe dëshiroj t'ia ritheksoj se sekretarët permanentë dhe ushtrues të detyrës funksionojnë mbi bazën e Rregullores për shërbimin civil, e cila parasheh që rolin e ushtruesit të detyrës të sekretarit permanent mund ta ketë zyrtari më i lartë në administratën e përgjithshme.

Tani më lejoni të përgjigjem në pyetjen tuaj. Projektligji për konfliktin administrativ është paraparë me strategjinë legjislative të vitit 2010, në bazë të kësaj strategjie është paraparë në muajin mars. Mirëpo, më lejoni t'ju informoj se ky projektligj tanimë është dorëzuar në qeverinë e Republikës së Kosovës dhe sigurisht që do të procedohet në gjashtëmujorin e parë të kësaj legjislature. Me miratimin e këtij projektligji dhe të

Projektligjit për procedurën administrative ne po e krijojmë të ashtuquajturin kodë të procedurës administrative dhe, siç e keni thënë edhe ju në pyetjen e juaj, po sigurojmë edhe një mbrojtje gjyqësore të qytetarëve në procedura administrative. Pra, me miratimin e këtij ligji, qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë mundësi të hapin procedura gjyqësore për vendime të formës së prerë të gjykatave dhe kjo është një garanci shtesë, një garanci e të drejtave kushtetuese të qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, ke pyetje shtesë? Jo. Edhe unë ju falënderoj juve.

Deputeti Esat Brajshori, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Kabinet qeveritarë,

Në mbledhjen e Qeverisë të datës 18 janar 2010, është marrë vendimi numër 01/105 që është nënshkruar nga kryeministri i Kosovës, në të cilën miratohet rekomandimi i propozuar nga Komiteti Drejtues Ndërmintor për ndërtimin e autostradës Vërmicë – Prishtinë – Merdarë, pra Vërmicë – Prishtinë – Merdarë. Në të njëjtën mbledhje, ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, zoti Limaj deklaron se: Sipas propozimit të kompanisë del se për 36 muaj pritët përfundimi i gjithë autostradës nga Besia në Sllatinë – Orllat, pjesa që është investim i Qeverisë së Kosovës, pastaj nga Orllati deri në Vërmicë. Pra, kemi të bëjmë me dy deklarata të ndryshme për të njëjtin projekt sa i përket gjatësisë së ndërtimit të autostradës.

Zoti kryeministër,

A do të ndërtohet autostrada sipas deklaratës suaj, pra Vërmicë – Prishtinë – Merdarë, apo sipas deklaratës ...

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar zoti Brajshori për pyetjen tuaj!

Ajo çka është më e rëndësishme, dua të potencoj para gjithë juve, të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar dhe qytetarë të Republikës së Kosovës, është se angazhimet tona negociuese me konzorciumin Behtel & Enka, janë në fazën përfundimtare të Qeverisë së Kosovës për fillimin e projektit të autostradës së ëndrrave të qytetarëve të Kosovës, do të thotë, Vërmicë – Prizren - Therandë – Prishtinë deri në Merdarë dhe këtu dërgoj mesazhin për ata zëra që kanë pretenduar se rruga do të ndalet në Prishtinë. Autostrada do të vazhdojë deri në pikën kufitare, nga pika kufitare e Shqipërisë, përgjatë Prishtinës deri në pikën kufitare me Serbinë, pra deri në Merdarë.

I nderuar zoti Brajshori,

Ju jap të drejtë nëse keni lexuar në gazeta të ndryshme opinion që e shfaqët ju, por dua të potencoj se është një interpretim, është një qëndrim i njëjtë me interpretime të ndryshme në dy gazeta të ndryshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, ke pyetje shtesë?

ESAT BRAJSHORI: Mbase më shumë koment se sa pyetje, zoti kryeministër. Jo, unë i kam lexua edhe mediat, nuk diskutohet, por unë po i referohem konkretisht vendimit të mbledhjes, të cilën e citova më lartë dhe bëhet fjalë për datën 18 janar 2010, numër 02/105, do me thënë, dokumenti i kryeministrit. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!
Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar deputet Brajshori,
Duhet bërë dallimin mes projektit gjeneral, të përgjithshëm, madhor, gjithë projektin dhe dallimin e punimeve në faza. Prandaj, kjo është edhe përgjigja të cilën është nga Qeveria e Kosovës dhe unë, si kryeministër. Pra, projekti gjeneral është Vërmicë – Merdarë, ndërsa fazat e punimeve janë diçka tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, për sqarimin!
Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NAIM RRUSTEMI: Unë këtë pyetje e kam trajtuar edhe herën e kaluar, por tash e kam ndryshuar pak sa për hatër të asaj që do të vazhdoj të bëjë të njëjtën pyetje derisa të gjenden ku janë 16.200.000 euro që është dashur të inkasohen në Thesarin e buxhetit të Kosovës. Pyetja ime: - Në shkurt të vitit 2007, komisioni ka vlerësuar tenderin për licencën e dytë të Telefonisë Mobile në Kosovë dhe i ka dhënë pikët maksimale konzorciumit “Kosmocent”, në përbërje të të cilit kanë qenë edhe kompanitë e fuqishme vendore me ofertën prej 81 milionë euro, 20% aty ka qenë, ashtu e kanë komentuar të gjithë, e ka garantuar edhe ART-ja, se aty është garancioni bankar. Pyetja ime konkrete është: - Ku është garancia bankare prej 16.200.000 euro për Operatorin e dytë të Telefonisë Mobile?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Përshëndetje, i nderuar deputet!
I nderuar kryetar i Parlamentit,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, kolegë ministra, shumë të nderuar deputetë,
Drejtën të them, po çuditë pse pyetjen për mua, kur të gjitha procedurat janë zhvilluar në vitin 2007. ART-ja është organi që merret me këtë çështje, ai është organ i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është Rregullatori i Pavarur, në të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do të duhej të ndërhynte. Megjithatë, unë dua të shpjegoj për ju dhe për qytetarët e Kosovës dhe për gjithë audiencën prezente se unë i kam bërë të gjitha hulumtimet për këtë dhe përgjigja është: Në ART është garancioni bankar prej 16,2 milionë euro, është valid deri në vitin 2011 dhe unë e kërkoj po aq me forcë, sa ju e kërkon, nga ju që jeni autoritet mbi Rregullatorin, që të detyroni që të ekzekutohen ato 16,2 milionë euro. Nuk është Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, as Qeveria e

Kosovës që do të duhej të ndërhynte në këtë, por ju shfrytëzoni të drejtën dhe përgjegjësitë e juaja kushtetuese dhe institucionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, pyetje shtesë ke a s'ke? Hajt, merre fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Unë ministrin e pyeta a janë paratë e deponuara në Thesar. Pyetja konkretisht u drejtohet juve, ministër, sepse jeni përgjegjës për Thesarin e Kosovës. Por, faleminderit që e keni identifikuar se ku janë, pse nuk deponohen ato para në Thesarin e Kosovës kur dihet se shefi i ART-së është ambasador i Kosovës në Slloveni, pse nuk i ka deponuar në Thesarin e Kosovës deri më tani 16.200.000 euro dhe pse nuk kërkoni ndihmë nga EULEX-i, nëse ju nevojitet, se aty dikush ka faj që nuk i deponon. Ato është dashur, moti është dashur të jenë në Thesarin e Kosovës. Në momentin që është tërhequr me Ligjin e prokurimit publik, ato është dashur të deponohen dhe të konfiskohet garancioni bankar, sepse fituesi i Operatorit të Dytë Mobil është pikërisht ofertuesi i dytë, me vlerë prej 42 milionë eurove, që është çuditërisht Telekom Sllovenia, ku shefi i ART-së bëhet ...

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Naim i nderuar,

Viti 2007 është 2007, apo? I gjithë procesi ka ndodhur në vitin 2007, kur as unë, as kjo Qeveri nuk ka qenë në pushtet në atë kohë, një. Dy, ART-ja është institucion i Kuvendit të Kosovës dhe ju duhet ta thirrni kryetarin dhe Bordin, pse nuk është ekzekutuar ajo. Ju lutem, shumë, ju si Kuvend duhet ta bëni këtë. Unë, si ministër i Ekonomisë dhe Financave kërkoj po aq me fuqi, sa edhe ti kërkoje, që kjo të ekzekutohet. Nuk besoj që do të duhej të ishte proces, çështje e cilitdo institucioni tjetër, është në duart tona, të këtij institucioni, ku unë sot po flas. Ju ta thirrni kryetarin e Bordit, t'i thirrni institucionet dhe të bëni këtë. Në momentin kur ajo ekzekutohet, paratë deponohen në Thesarin e Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë, pyetja e radhës. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren Justina Shikora Pula. A doni ta lexoni pyetjen, ministrja s'është këtu. Regjia, fjalën deputetit Driton Tali!

DRITON TALI: Jo, po e pres, jam kah e pres që nga fillimi i dhjetorit për nja dy pyetje ministren Justina Shikora Pula. Shpresoj se do të vijë të paktën në vitin 2010 dhe do të pres derisa të vjen ajo t'ia bëjë pyetjen. Këto pyetje do t'i përsëriten zonjës ministre derisa ajo të vijë në Parlament, shpresoj që brenda vitit 2010 njëherë ajo do të gjejë kohë për të ardhur në këtë Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju e dini, pyetjet që s'marrin përgjigje, mbas dy seancave botohen në Buletinin e Kuvendit.

Deputeti Bujar Dugolli, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Unë do të ngreh një çështje tjetër që ka të bëjë me përmirësimin e menaxhimit të ndërmarrjeve publike, e cila ka qenë sfidë edhe në të kaluarën, por është sfidë edhe tash për institucionet e Kosovës. Pyetja konkrete është: - Çka jeni duke ndërmarrë ju që të përmirësohet menaxhimi i ndërmarrjes publike “Termokos”, Shoqëri Aksionare në Prishtinë, ku dihet mirë se tash e dy vite me radhë qytetarët e Prishtinës ballafaqohen me problemet e shumta, si me mosfurnizim me ngrohje, shkyçje kolektive e ngrohjes, shërbime të dobëta dhe aty ku ka shërbime – çmimet janë jashtëzakonisht të larta? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Dugolli,

Që nga 15 qershori i vitit 2008, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit mbi ndërmarrjet publike, të gjitha përgjegjësitë dhe pronësitë e ndërmarrjeve publike janë transferuar nga UNMIK-u në Qeverinë e Kosovës.

Ndërmarrjet publike lokale, ku hynë “Termokosi” në bazë të kualifikimit të Ligjit për ndërmarrjet publike është Ndërmarrje Publike Lokale dhe pronar 100% i kësaj ndërmarrje është komuna e Prishtinës. Që nga 15 qershori e kam dhënë këtë përgjigje edhe një herë. Që nga 15 qershori i vitit 2008, pra po thuaj se dy vjet, përgjegjësitë për menaxhimin, monitorimin, financimin vinë në komunën e Prishtinës. Megjithatë, duke ditur se gjatë transferimit të një periudhe tranzitore do të jetë vështirë për një komunë, edhe pse kaq e madhe, por megjithatë Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete, qoftë për subvencionim, qoftë për investime kapitale edhe për “Termokosin”.

Më lejoni t’i them disa shifra. Në vitin 2009, “Termokosi” ka marrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave 1.593.000 euro mjete për subvencion, pra për importin e mazutit, dhe 295.000 euro për investime kapitale. Pra, pa marrë parasysh që është transferuar në komunë, ne i kemi dhënë para. Prapë, në vitin 2010, pra me këtë buxhet, që është aprovuar në Kuvend, Qeveria ka planifikuar që edhe për këtë, edhe për Gjakovën, pra dy ngrohoret, të ndajë shuma të caktuara të mjeteve. Ndërsa, për “Termokosin” janë 1.970.500 euro, nga të cilat janë transferuar në xhirollogari tani 615.000 euro për periudhën pranverore dhe i kemi lënë 422.000 euro për periudhën vjeshtore, sepse buxheti dihet që është për një vit.

Po ashtu, ne zotohemi se do të bëjmë gjithçka që është e mundur për të ndihmuar, por përgjegjësia do të jetë e qartë, sepse shpeshherë po kritikohet Qeveria. Përgjegjësia për menaxhimin e “Termokosit” është komplet në komunën e Prishtinës. Ne i kemi ndarë thash 1. 970.500 euro për mazut dhe 277.000 euro për investime kapitale, kështu që do t’ju kisha lutur që këtë shqetësim ta bartni te organet që janë kompetente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Bujar, a do fjalën?

BUJAR DUGOLLI: Faktikisht, e falënderoj ministrin që e orientoi përgjegjësinë, megjithatë Ministria e Pushtetit Lokal është e autorizuar të mbikëqyrë se si po zbatohet pasi që aksionar i ndërmarrjeve publike është Qeveria e Kosovës. Qytetarët e Prishtinës ballafaqohen tash e dy vite në lagjen konkrete, Dardania, që s'ka nxemje. Ky menaxhment ka dështuar t'i inkasojë mjetet, ky menaxhment në mes të dimrit deklaroi se s'ka mazut, çka i duhet më shumë Qeverisë dhe komunës së Prishtinës që ta kuptojë se ky menaxhment i kësaj ndërmarrje është i dështuar dhe të ndërmerren masa. Kjo është çështja që e kam ngritur. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër e ke fjalën, edhe pse ndërmarrjet publike janë kompetencë e komunës.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryetar!

Unë veç desha edhe një sqarim. Vetëm ndërmarrjet publike qendrore janë pronë dhe kompetencë e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Të gjitha ndërmarrjet lokale, siç është "Termokosi", ndërmarrjet tjera të pastrimit ose çfarëdo qoftë, që nuk shërbejnë ose nuk ofrojnë shërbime më shumë se sa në tri komuna, ato janë ndërmarrje qendrore, prandaj ne ndihem përgjegjës për KEK-un, për Postën, për Aeroportin, për Ibër-Lepencin, për të tjera që janë në listë dhe i keni në ligj, në listë cilat janë. Por, do t'ju kisha lutur, sinqerisht, unë kërkoj edhe mirëkuptim prej qytetarëve të Kosovës, edhe prej qytetarëve, posaçërisht të Prishtinës, që të kërkojnë përgjegjësinë ose të kërkojnë zgjedhjen nga ata për të cilët Ligji i përcakton përgjegjësitë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Pyetja e radhës nga deputetja Teuta Hadri, për ministrin e Mjekësisë, zotin Alush Gashi.

TEUTA HADRI: Zoti ministër,

Qeveria e Kosovës vazhdimisht ka bërë apel dhe angazhohet për shtimin e produkteve vendore, duke ikur nga importi i produkteve të jashtme. Pyetja ime: - Pse Ministria e Shëndetësisë po bën pengesë në shtimin e produkteve të kompanisë farmaceutike "Kondirolli", kompani e cila i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe standardet ndërkombëtare dhe ju bëni pengimin e këtyre produkteve?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, i nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ju faleminderit, zonja deputete për pyetjen e shtruar! Me të vërtetë, me sinqeritetin më të plotë, si Kuvendi, ashtu edhe Qeveria është e interesuar për prodhime vendore. Pyetja juaj duket që nuk është e saktë. Kompania "Kondirolli", nën udhëheqjen e zotit Nexhat Kondirolli e ka licencën valide të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për prodhime vendore. Licenca është valide deri më 20 tetor të vitit 2010 dhe gjatë kësaj kohe kompania e di që mund të aplikojë për licencim. Nëse është në pyetje ndonjë çështje

tjetër, për ndonjë specifike të ndonjë bari për prodhim, ata i dinë procedurat që duhet të kërkohet leja për prodhimin e barit specifik nga Agjencioni Kosovar i Produkteve Medicinale. Unë nuk jam në dijeni që ekziston ndonjë pengesë. Ju lus juve, si sponzorues i pyetjes, që të bisedoni me ta, janë të mirëseardhur në çdo kohë që ne brenda dite t'u japim përgjigje, aq më tepër kur për shkak të punës së mirë në Ministri të Shëndetësisë në dy vitet e fundit, Agjencioni Kosovar i Produkteve Medicinale e ka fituar projektin e Komisionit Evropian për instrumentin e para anëtarësimit në vlerë prej 2.5 milionëve dhe është binakësuar me institucione relevante të Bashkimit Evropian për ngritje të cilësisë së Agjencionit Kosovar të Produkteve Medicinale. Ne e mirëpresim pyetjen tuaj, ju lutem, bisedoni me ta, janë të mirëseardhur që nëse ekziston ndonjë problem për të cilën nuk jam në dijeni, sepse ata e kanë licencën valide për veprim, për prodhim të produkteve medicinale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër shumë!

Deputete, a je e kënaqur me përgjigje, apo ke ndonjë pyetje shtesë?

TEUTA HADRI: ... të vizitohet kjo kompani, e cila ka investuar me miliona euro në Kosovë dhe nuk iu ka lejuar shtimi i produkteve në krahasim me metrazhin që i ka 4000m², ndërsa kompanive tjera me metrazh më të vogël - 200m² prodhojnë më shumë, prandaj shkon kjo në falimentim dhe është për keqardhje të Kosovës se 1500 vende pune hapen nëse u lejohej shtimi i produkteve. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër,

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit!

Unë vetëm mund ta përsëris, se kanë licencë valide për veprimtari dhe, ju lus, nëse ndonjë pyetje shtesë, janë të mirëseardhur që të marrin përgjigje në kuadër të ligjeve të vendit tonë. Nëse është ndonjë ligj pengesë, ne kemi mundësi të fillojmë procedurat për ndërrim dhe plotësim të ligjit. Por, nuk jam në dijeni që ekziston kërkesë e tyre në Ministri, kërkesë shtesë. Ata kanë licencë valide dhe, sa jam në dijeni, pajisja dhe teknologjia në këtë institucion është e nivelit të standardeve evropiane. Kanë licencë valide. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Prandaj, le ta respektojnë ligjin.

Deputeti i radhës për pyetje është Xhevdet Neziraj, për ministrin Nenad Rashiq. Deputet, e ke fjalën. Deputeti Xhevdet Neziri, pyetje për ministrin Nenad Rashiq dhe Nenadi është këtu.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëpo, unë jam drejtuar për ministrin e Komuniteteve dhe Kthim, edhe ai e ka mbiemrin Rashiq.

KRYETARI: Unë po kërkoj falje për shkak se administrata e ka lëshuar gabimisht. A do ta lexosh pyetjen?

XHEVDET NEZIRAJ: Po e lexoj pyetjen, se e di që nuk vjen ministri.

Zoti ministër,

Pasi nga buxheti i vitit 2009 keni ndërtuar ndërtesa për banim në LLapllaselë, ndërsa në vitin 2010 keni paraparë ndërtim të ndërtesave për banim në Graçanicë dhe Llapllasellë, banime këto vetëm me pjesëtarë të komunitetit serb. Pyetje: - A e keni ndërmend të ndërtoni ndonjë ndërtesë të banimit edhe për komunitete tjera, apo t'i lejonit komunitetet tjera të banojnë në kampe?

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministren Nekibe Kelmendi. Deputete, mund ta bëni pyetjen.

LULJETA SHEU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara ministre,

Rastet e të miturve që shkaktojnë ndonjë vepër penale dhe janë nëpër burgje në Kosovë, trajtimi i tyre është shumë i ndjeshëm dhe për sigurinë e tyre kërkohet një tretman i veçantë. Pyetja është: - Si i trajtoni personat e mitur nën moshën 16 vjeçare kur ata i kryejnë veprat penale?

KRYETARI: Zonja ministre, e ke fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Meqë çështja e ngritur dhe pyetja e ushtruar lidhet me të miturit, do të përqendrohemi të përgjigjem vetëm për këtë kategori të kryesve të veprave penale.

Sipas nenit 2 të Ligjit penal për të miturit, i cili tani veç do të ndryshohet dhe sot është në rend të dite, kategorisë së të miturve u përkasin personat e moshës 14 deri 16 vjeç, kurse madhor i ri konsiderohet personi në mes të moshës 18 deri në 20 vjeç. Të miturit të cilët i përkasin kësaj kategorie e të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 6, paragrafi 1 të Ligjit në fjalë nuk mund të dënohen me burgim për të mitur, por ndaj tyre mund të shqiptohen vetëm masa diversiteti dhe masa edukative. Pra, dënim për të mitur nuk ka.

Me nenin 6.3 të Ligjit në fjalë, ndaj të miturit mund të shqiptohet masa edukative me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilën e zbaton Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit. Në praktikat e gjertanishme, masat më të shpeshta që shqiptohen ndaj të miturve janë masat edukative. Në këto masa bëjnë pjesë: masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale. Për shkak të mungesës së institucionit edukativ, përkatësisht të Qendrës Edukative për të Mitur, si masë që është në interesin e të miturit, sepse atij i nevojitet mbikëqyrje e plotë nga edukatorët adekuat, ku edhe kohëzgjatja është më e shkurtër se dërgimi në institucion

edukativo-korrektues, siç ndodh tani, zakonisht gjykatat, varësisht nga pesha e veprës penale, këtë kategori të kryesve të veprave penale, pra, të miturve, këtyre ua shqipton masën e dërgimit në Institucionin Edukativo-Korrektues në Lipjan.

Ministria e Drejtësisë për mungesë, po e përsëris, të një institucioni edukativ apo qendre edukative, po i dërgon në Institucionin Edukativo-Korrektues në Lipjan. Kjo ministri është duke u përpjekur të sigurojë mjete buxhetore, sepse e dini se edhe buxheti i Kosovës nuk mund t'i arnojë të gjitha birat, siç thotë popullit, por po kërkojmë...

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni kohën ministres!

MINISTRAJ NEKIBE KELMENDI: ...sa më shpejt të ndërtojë një qendër edukative për t'u krijuar mundësia që gjykata ndaj të miturve nën moshën 16 vjeçare më shpesh ta shqiptojë këtë masë, sepse është në interesin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Deputete, a ke pyetje shtesë? Ju faleminderit!

Kjo ishte edhe pyetja dhe përgjigja e fundit për seancën e sotme se edhe koha ka skaduar. Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seancat plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit.

(Reagim nga salla)

Ti e lexo detyrën tënde dhe e sheh se çfarë mundësish ke.

Pika e tretë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit për drejtësinë për të mitur

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 e Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projekt-kodi.

Ftoj ministren e drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantoj Projekt-kodin.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar, kryesues i seancës, sërisht të nderuar deputetë,

Ministria e Drejtësisë, krahas hartimit të katër ligjeve për reformën gjyqësore: Ligjin për gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor, Ligjin për Prokurorinë, për prokurorin e shtetit dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial, pastaj kompletimin e legjislacionit antikorrupsion, të cilat ligje tanimë janë të miratuara, iu ka qasur edhe reformës së drejtësisë për të mitur me hartimin e Projektligjit të Kodit të drejtësisë për të mitur, që deri me tani është quajtur Ligji për të mitur.

Ky projekt është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore të drejtësisë për të mitur, si kategori

e veçantë e shoqërisë kosovare. Në hartimin e këtij draft-kodi, kanë marrë pjesë edhe ekspertët e organizatës së UNICEF-it, kontributi i të cilëve është shumë i çmueshëm.

Kuvendi i Kosovës, para shpalljes së pavarësisë kishte miratuar Ligjin penal për të miturit i cili ka filluar të zbatohet bashkë me dy kodet e drejtësisë penale materiale dhe procedurale që nga prilli i vitit 2004. Për shkak të disa kufizimeve me Kornizë Kushtetuese të kohës, u pa si e domosdoshme që të reformohet drejtësia për të mitur dhe në vend të Ligjit për të mitur, të hartohet Kodi i drejtësisë për të mitur, i cili është më gjithëpërfshirës, më i avancuar, është i plotësuar edhe me institute të reja dhe është në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare, si dhe me vetë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Të miturve.

Qëllimi parësor i këtij projekt-kodi është mbrojtja e mirëqenies së të miturit dhe siguri se çdo reagim ndaj kryerësve të mitur, do të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe të peshës së veprës penale.

Projekt-kodi i drejtësisë për të mitur, ka 22 kapituj dhe 163 nene. Për zbatimin e këtij ligji nevojitet kostoja financiare, investime kapitale, pikërisht ajo që u përgjigja në pyetjen e deputetes, zonjës Luljeta Shehu, ndërtimi i një qendre edukative për të mitur ndaj të cilëve si kryerës Gjykata ka shqiptuar masën edukative e cila në parim, do të duhej të zbatohet në Institutin apo Qendrën Edukative. Mjetet janë të parapara për periudhën 2010-2012, ndonëse edhe kjo qendër paraqet sfida sipas raportit të progresit.

Sipas këtij projekt-kodi, masat që mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur janë:

- Masat e diversitetit, dhe
- Masat edukative

Privimi i lirisë u shqiptohet kryerësve të mitur vetëm si mjet i fundit dhe kufizohet në afat sa më të shkurtër. Burgimi i të miturit ka për qëllim vetëm rehabilitimin dhe zhvillimin e kryerësit të tij, veçanërisht edukimin e rregullt apo edukimin e specializuar, nëse ai për shkak të veprës penale ka mbetur në gjysmë, aftësimin profesional dhe zhvillimin e duhur personal të miturit. Burgimi për të mitur, gjithashtu do të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjet për ta parandaluar atë që të mos i përsërisë në të ardhmen veprat penale.

Projekt-kodi i drejtësisë për të mitur përmban pjesën materiale dhe procedurale, prandaj edhe është kodifikuar në një vend edhe e drejta materiale edhe procedurale për të qenë më lehtë edhe për t'u zbatuar në praktikë.

Projekt-kodi në fjalë përcakton parimet e procedurës gjyqësore edhe atë prej momentit të inicimit të procedurës e deri në përfundimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas këtij kodi, autoritetet apo institucionet që marrin pjesë në procedurën gjyqësore ndaj të miturit, obligohen të veprojnë shpejt dhe pa vonesa të panevojshme, më shpejt se sa kërkohet për madhorët me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Vlen të theksohet se për fëmijën nën moshën 14 vjeçare, nuk fillon asnjë procedurë gjyqësore. Nëse kjo procedurë ka filluar eventualisht për mungesë të të dhënave lidhur me moshën e të miturit, sepse nuk është siguruar ndonjë certifikatë për t'u vërtetuar se është nën moshën 14 vjeçare, atëherë kur ky fakt të vërtetohet, çdo procedurë e iniciuar menjëherë do të pezullohet dhe përkitazi me këtë do të informohet apo do të njoftohet Qendra për Punë Sociale. Kjo është detyrë e prokurorit të shtetit.

Projekt-kodi i drejtësisë për të mitur, në mënyrës të veçantë cakton rregullat e procedurës së ndërmjetësimit për të mitur, që është një institut krejtësisht i ri, i futur në këtë projekt-kod për të mitur. Ky është një institut alternativ në sistemin juridik penal të Kosovës, por edhe në çështjet civile. Procedura në fjalë është jashtëgjyqësore dhe zhvillohet nga personi i tretë, ndërmjetësuesi, vetëm atëherë kur ekziston vullneti i lirë dhe pjesëmarrja e të dy palëve, e kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar. Ky institut ndikon në avancimin e legjislacionit në këtë fushë e me këtë edhe avancimin e të drejtave të vetë palëve në procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme në një afat të arsyeshëm kohor, si dhe e zvogëlon stërngarkimin e gjykatave me lëndë të cilat janë në procedurë.

Inkorporimi i këtyre dispozitave ligjore avancojnë të drejtat e të miturve, sepse shqiptimi i masave dhe i dënimeve ndaj të miturve, bëhen vetëm me qëllim të korrektimit, risocializimit dhe përgatitjes së tyre për një jetë normale në liri. Dhe, në fund, Projekt-kodi i drejtësisë për të mitur, përkujdeset sidomos për ruajtjen e integritetit të miturve, në mënyrë që kur ta arrijnë moshën madhore, të mos ndikojë dënimi ose masa e shqiptuar në ardhmërinë e tyre apo ta dëmtojë ardhmërinë e tyre, që do të thotë se gjithmonë i ka para vetit interesat e të miturve, sepse janë kategori e veçantë dhe mund të bien në mashtime shumë lehtë.

Drejtimin e Mbledhjes e merr anëtarin e Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre Kelmendi!

Tash do të hapim debatin për diskutim në parim të këtij ligji të propozuar. Kryetari ose raportuesi i Komisionit Funkcional për Legjislacion dhe Gjyqësi, nëse e do fjalën.

E do fjalën, urdhëro, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministër,

Ministra

Të nderuar kolegë deputetë

Projekt-kodi i drejtësisë për të mitur është shqyrtuar në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe natyrisht Komisioni e ka përkrahur që të votohet në parim.

Unë do t'i them vetëm disa shqetësime që do t'i kemi për projektligjin, të cilat, ndoshta është mirë që si Kuvend t'i debatojmë. Janë disa institute të cilat janë paraparë në projektligj, të cilat kanë qenë edhe në Ligjin e kaluar penal për të mitur. Ju e dini që si Komision për Legjislacion e kemi monitoruar një kohë të gjatë zbatimin e Ligjit penal

për të mitur dhe ky Kuvend ka nxjerrë disa rekomandime për jo zbatimin ndoshta, jo nga ajo që nuk ka vullnet për t'u zbatuar ligji, por disa institute të cilat janë paraparë në këtë ligj, ka qenë e pamundur për t'u zbatuar. Është një dukuri e njëjtë edhe pas rekomandimeve, në këtë projektligjin e ri apo kodin e ri të drejtësisë, janë paraparë pothuaj të njëjtat institute edhe për të cilat do të ketë dilema se edhe nëse i aprovojmë si Kuvend i Kosovës, që janë konform standardeve, janë të nxjerra mirë, mirëpo ka dilema që nuk do të zbatohen kurrë në praktikë.

Është paraparë që kapitulli i tretë flet për ndërmjetësimin, kapitulli i katërt flet për procedurat e ndërmjetësimit. Ju e dini që kemi një ligj për ndërmjetësimin dhe unë e di që një pjesë e këtyre paragrafëve i kanë rregulluar vetëm çështjet specifike, por ndoshta ka qenë mirë që të jenë me një kapitull, sepse është, besoj që, nëse flitet për ndërmjetësimin në kapitullin e tretë, flitet edhe për procedurat e ndërmjetësimit, sepse kapitulli i katërt tash mund të ndahet në pjesë të veçanta.

Është paraparë në nenin 24, mbikëqyrja në familjen tjetër dhe unë po ju them sinqerisht nga monitorimi i Ligjit paraprak, kemi konstatuar se ky paragraf apo nen i ligjit që është në fuqi, nuk është zbatuar asnjëherë. Dhe, unë besoj që edhe në këtë ligj nuk do të zbatohet asnjëherë, nga vetë fakti që ne nuk kemi një kod buxhetor ku i garantojmë familjes tjetër që nëse e merr në përkujdesje një fëmijë i cili bie ndesh me ligjin, t'i ndajmë mjetet për ta mbikëqyrur. Dhe, ne e dimë hallin e qytetarëve të Kosovës që aktualisht ndoshta asnjë familje nuk ka mundësi, prandaj ky institut është paraparë, por nuk e di se si do të zbatohet në praktikë.

Çështja tjetër, më me interes është çështja, ne gjatë monitorimit të ligjit, kemi konstatuar se janë vetëm 4-5 gjyqtarë në krejt Kosovën që vendosin për gjykimet për të mitur që nuk e kanë vetëm çështjen e gjykimeve, por e kanë të vizitave, mandej përcjelljen e të miturit nga masat që i ka shqiptuar deri te dënimi përfundimtar. Çështja është, a po mendojmë, duhet të mendojmë që të jetë një numër i caktuar i gjyqtarëve të profesionalizuar, sepse kështu i kërkon ligji dhe aktualisht një gjyqtar i Prishtinës vendos për 4-5 komunat tjera. Dhe, gjatë monitorimit kemi konstatuar se gjyqtarja nuk ka arritur asnjëherë t'i vizitojë të miturit, ia ka shqiptuar masën e dënimit dhe asnjëherë më nuk ka ditur se çka po bëhet me atë masë të dënimit. Prapë e kemi paraparë këtu në këtë ligj. Ne duhet të mendojmë që nga organet e drejtësisë kërkojmë që së paku në Kosovë të kemi minimum 30 gjyqtarë për të mitur, secila komunë apo secila gjykatë së paku ta ketë një gjyqtar për të mitur dhe prokurorë të cilët do të jenë të profesionalizuar.

Gjithashtu, e tha edhe ministrja, por po e përsëris. Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucione të posaçme nuk është bërë kurrë, sepse s' kemi dhe ne po e parashohim prapë në ligj, por kjo nuk garanton që ne do ta aprovojmë. Unë besoj brenda dy muajve me procedurë të rregullt do ta aprovojmë, por asnjëherë kjo, ky nen i këtij ligji nuk do të aprovohet, sepse nuk kemi më, nuk kemi qendër edukuese, këtu është problemi. Dhe, një dilemë shumë e madhe është, a duhet, e nderuara ministre, që me këtë ligj, të kërkojmë që Qendra që është në Lipjan, që për mua nuk është Qendër Korrektuese-Edukuese, se është një lloj i burgut, i burgut të hapur ashtu siç është paraparë, që të

ndryshohet së paku me këtë ligj, t'ia ndryshojmë pamjen. Nëse shkojmë në Lipjan, tamam e shohim një qendër e burgimit për kriminelët më të mëdhenj që mund të bëhet, së paku këtë formë t'ia ndërrojmë kësaj qendre dhe të mos të shohim atje gjemba, pa nevojë të cilat janë vendosur në një periudhë nga faktori ndërkombëtar dhe është mirë që të bëjmë iniciativa, ka qenë edhe rekomandim i Komisionit që ta shndërrojmë tamam në Qendër Korrektuese Edukuese, por jo në një formë siç është tani. Dhe, krejt në fund, ndoshta është mirë që të mendojmë paraprakisht, që të ndajmë buxhet për këto çështje që i përmenda, që të mos mbetet që ta aprovojmë një ligj dhe të mos jetë i zbatueshëm në pjesën më të madhe të neneve apo paragrafëve që i ka. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Unë do të përpiqem t'i identifikoj kush flet në emër të grupeve, por ju kisha sugjeruar që sot që është mirë që ata që marrin detyrat t'i përfaqësojnë grupet parlamentare në diskutimet e para për ligjet, nëse s'janë shefa të grupeve, të mësohen ta japin në listë emrin këtu në kryesim. Kjo vlen për më vonë.

Për Partinë Demokratike të Kosovës, po e zëmë që flet Selvie Halimi, a është ashtu?

SELVIE HALIMI: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur dhe jep pëlqimin që ky projekt-kod të aprovohet në parim. Duke pasur parasysh se në dispozitat e këtij projekt-kodit duhet të bëhen disa plotësime sqaruese me qëllim të evitimit të mundësisë së shumë interpretimit.

Kryesisht duhet të ndalemi në plotësimet sqaruese në nenin 13, 16, 18, 24, 70 dhe prej nenit 120 e tutje. Do të thotë këto sqarime plotësuese do të jenë, po e cek edhe një herë për ta evituar mundësinë e shumë interpretimit gjatë zbatimit në praktikë. Dhe, njëherit kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë, gjegjësisht Qeveria, që të ndajë buxhet, me qëllim që të ngritën të gjitha kapacitetet që ky projektligj të mundë të zbatohet ashtu si duhet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete për qartësi dhe shkurtësi. Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zoti kryesues,

Deputetë dhe ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projekt-kod të drejtësisë për të mitur dhe është i mendimit se ky kod duhet të votohet, me ndonjë vërejtje që do të jepet ose tash ose në leximin e dytë.

Ky kod mendojmë se është formuluar mirë në tërësi. Moshat janë përcaktuar mirë që në fillim, po ashtu edhe nocionet, me ndonjë lëshim të vogël, që do ta shqyrtojmë ndoshta në analizat e mëvonshme. Projekt-kodi i përbërë prej 5 pjesësh, 163 nenesh dhe 20 krerësh, është një kod i mirë se prituri, mendojmë ne edhe që duhet të zbatohet në të ardhmen, me gjithë vështirësitë që ka që i theksuan edhe parafolësit e mi, me të cilët jam edhe anëtar i Komisionit dhe pajtohem me ato vërejtje që i dhanë.

Unë mendoj se, ne në të vërtetë mendojmë këtu, në Lidhjen Demokratike se ligji në tërësi duhet të shikohet sidomos në disa nene që kanë të bëjnë me ndonjë lëshim të vogël. Kështu, fjala vjen, në një pjesë të nenit 52, paragrafi 1, duhet të plotësohet dhe ky nen ka të bëjë me Gjykatën Supreme, ku thuhet se ajo vetëm e ka kolegjin dhe cakton, por kolegjet i kanë edhe gjykatat komunale dhe gjykatat e qarkut. Po ashtu, nenin 34, paragrafi 2, ku parashihet dënimi deri në 5 vjet, për veprë penale, është i vogël edhe ne mendojmë se maksimumi duhet të jetë deri në 10 vjet, në krahasim me veprat penale për të rritur që janë shumë më shumë.

Po ashtu neni 63, duhet të përcaktohet se sa herë duhet ta njoftojë prokurori gjykatën. Mendoj që, me qëllim të mos zvarritjes së procedurës, prokurori duhet ta njoftojë vetëm një herë mbrojtësin e jo disa herë, siç është paraparë me këtë nen. Kështu edhe neni 70, paragrafi 1, paraprakisht gjyqësori do ta shqyrtojë dhe gjyqtari, desha të them, për të arritur, duhet të caktojë shqyrtimin gjyqësor në një periudhë më të gjatë se 8 ditë, që është paraparë këtu, se për 8 ditë nuk mund të merret fëmija, nuk mund të caktohet dhe kërkohet një zgjatje e kohës.

Prandaj, ne mendojmë se më gjithë këto vërejtje të vogla që u vërejtjen, pas analizës së mëvonshme edhe ne, në Lidhjen Demokratike do ta japim atë ndihmesën tonë që ky kod të përmirësohet edhe më tej, të herret ndonjë element, ndonjë pjesë që është e tepërt dhe kodi të dalë i plotë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet Hajdaraj! Për Grupin Parlamentar të AAK-së, flet deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ka shqyrtuar Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur. E përkrahim në parim, megjithëse dyshojmë në mundësinë e zbatimit të tij dhe nga vetë deklaratimet e ministres së Drejtësisë për shkak se nuk ekziston baza e caktuar, duke filluar nga Qendra e Edukimit e tjera, do të thotë, ndërkaq për ndarjen e buxhetit që është i planifikuar për dy vjet radhazi që të mund të rregullohet kjo qendër e edukimit, si dhe përmasat tjera që mund të rregullohen, masat e ...po them në kuadër të gjithë kësaj apo institucionale që i përdori ministrja. Ne e përkrahim edhe njëherë, por dyshojmë mundësinë e zbatimit kaq herët përderisa praktika e bazamentit tjetër nuk ekziston.

Ndërkaq, po e shfrytëzoj, zotëri kryesues edhe një tretman tjetër, duke parë se tjerët po e shfrytëzojnë mundësinë pas përfundimit të fjalimeve të tjerëve, ministri i nderuar, zotëri Arsim Bajrami, për mua do të jetë gjithmonë profesor, sepse ka qenë edhe profesor i imi, por e kisha lutur që të mos dalë edhe të flas nën diktatin e njerëzve që janë më të ulët profesionalisht se ai, sepse të isha unë në vendin e tij, do të kisha dhënë dorëheqje për shkak se Ligji bazë i administratës shtetërore shtyhet...

KRYESUESI: E kalove temën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: ... Zoti kryesues, vetëm edhe këtë. Ligji për administratën shtetërore nuk është i kushtëzuar me Ligjin për deputetët për shkak se

KRYESUESI: Po nuk është temë tash.

SHKUMBIN DEMALIAJ:.... Krejt në rregull, por po e shfrytëzojnë të tjerët, desha ta shfrytëzoj këtë rast, për shkak se ndihem obligativ ndaj opinionit, sepse vetë ky ligj nuk ka të bëjë njëri me tjetrin, sepse deputetët nuk janë shërbyes civilë edhe kisha thënë të mos përziejme këto gjëra kur nuk kanë përgjigje. Ju faleminderit, kryesues! Kërkoj falje.

KRYESUESI: Për Grupin Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, shefi i Grupit Ibrahim Makolli.,

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet në parim këtë projekt-kod duke e vlerësuar të një rëndësie të veçantë dhe kontributi ynë do të jetë në procedurat e mëtutjeshme gjatë punës. Unë, gjithsesi do të shtroja këtu vetëm një çështje se për t'u zbatuar me sukses ky kod në praktikë, nevojitet në radhë të parë ngritje e kapaciteteve. Ne të gjithë e dimë mungesën e prokurorëve dhe gjyqtarëve për të mitur, andaj mbetet shumë për të vepruar në këtë drejtim, në mënyrë që ligji të gjejë zbatim të drejtpërdrejtë në praktikë

Grupi Parlamentar i AKR-së, e mbështet ligjin në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Makolli!

Për Grupin "7+", deputetja Mufera Shinik.

Shikoni, më fal zonja deputete edhe pa komente e merr fjalën për LDD-n, cili flet prej jush. Zotëri, deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Me kohë e kam shtypur sustën, nuk e di atje çka ka dal...

KRYESUESI: Mos komentoni. Në çdo Parlament që është serioz, e do të duhej të bëhej ky i yni, kur ka shumë paraqitës të një grupi, zakonisht nëse s' paraqitet shefi i grupit, regjistrohen edhe nuk është kurrfarë problemi për ta qitur emrin këtu. Unë ju thashë që në fillim. Tash po dihet që ti flet, urdhëro, kjo është.

ADEM SALIHAI... Po, po u morëm vesh për të gjitha. Ju faleminderit!

Ne, në Komision për Legjislacion dhe Gjyqësi e kemi shqyrtuar vetëm në parim aspektin e përputhjes së këtij projekt-kodi me Kushtetutën. Nuk jemi lëshuar në çështje tjera dhe sigurisht se do ta diskutojmë gjer e gjatë këtë. Siç dihet, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka mbikëqyrë Ligjin penal për të mitur dhe ka bërë shumë rekomandime. Ne kemi hasur në shumë të meta edhe në ligj edhe në zbatimin e tij. Mendoj që një pjesë e madhe nuk është marrë parasysh dhe nuk është inkorporuar këtu e do të duhej të ishte inkorporuar se kanë qenë në fund rekomandimet e Kuvendit, jo

vetëm të Komisionit. Unë mendoj që do të kemi shumë punë në shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij ligji. Nuk ekzistojnë kushtet dhe institucionet përkatëse aq a duhet për zbatimin e tij, nuk ekzistojnë resurset njerëzore për zbatimin e tij dhe është një dukuri, të cilën ne do të bëjmë përpjekje ta evitojmë.

Komisionet tona, veçanërisht ky për Legjislacion dhe Gjyqësi, shpesh është shndërruar në servis të Qeverisë për përmirësimin e ligjeve të saj, dhe mendoj që roli i këtij Komisioni dhe i komisioneve tjera nuk është ky. Roli i komisioneve është politik, që ta vlerësojë anën politike të një ligji se është në përputhje me Kushtetutën, është apo nuk është i dobishëm për shoqërinë në Kosovë dhe jo të merret me pika, presje, nene, fjalë e tjera e tjera.

Megjithatë, ne jemi pajtuar që ta përkrahim në parim. E dimë që do të kemi shumë punë në përmirësimin e këtij ligji, po megjithatë na ka ra hise edhe kështu ka shkuar deri tash. Ne shpresojmë që në të ardhmen do të ndryshojë kjo situatë dhe deputetët që janë personalitete politike, jo juristë- profesionistë, nuk do të merren me punë që u takojnë zyrtarëve të Qeverisë apo ministrave të ndryshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! E merr fjalën Mufera Shinik, në emër të Grupit “7+”.

MUFERRA ŞINIK

Teşekkür ederim

Reşit olmayanlara ait Yasa kodunun iyi bir şekilde hazırlandığı görüşündeyiz. Ancak, bu Yasa kodu için ek bütçenin sağlanması gereklidir, çünkü reşit olmayanlar için yurtların ve eğitim merkezlerinin inşa edilmesi, gereken koşulların sağlanması ve etkinliklerini sürdürebilmeleri için lojistik desteğin sunulması gereklidir.

7+ Parlemlenter grubu Reşit olmayanlara ait Yasa kodununun ilk okunuşunu kabul etmekte, ikinci okunuşuna kadar ise kendi öneri ve uyarılarını fonksiyonal komisyona sunacaktır.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Për Grupin SLS, a ka? Nuk ka. Për Grupin për Integritet, deputeti Numan Baliq. Regjia, fjalën Numan Baliqit. Regjia, a jeni aty, apo s' po ju punojnë pajisjet?

NUMAN BALIĆ: Mirë. Tani, më në fund është në rregull. Ju faleminderit, zoti kryesues i Kuvendit!

Da poselamim sve koji su u sali, koji nas slušaju.

Iznjeću nekoliko, nadam se, sadržajnih prijedloga vezanih za ovaj zakon. Najprije se slažem u cijelini da je zakon obuhvatan, da govori o mnogo važnim pitanjima, da nudi dosta dobrih riješenja, mada u pojedinim djelovima preobimam je ili previše opisan, ali u cijelini je efektivan.

Ono što bih posebno izdvojio u ovom zakonu, jeste da je vrlo dobro što je urađen u saradnji sa UNICEF-om i da se to vidi na osnovu pristupa pitanja maloljetnika i posebno onog aspekta koji se tiče humanog pristupa po ovom pitanju, potom osvrta na stanje, interesovanje porodice i sve one mjere koje se izriču vezano za popravljivanje statusa osobe koja je delikvent ili je, da tako kažem, u sukobu sa zakonom po pojedinim pitanjima. Tako da razumna rješenja koja se predviđaju i mjere koje se preduzimaju, imajući u obzir bilo da su to odgojne mjere, odnosno vaspitne mjere, potom društveno koristan rad i zatvor kao zaista zadnja mjera koja se predviđa i koja se primenjuje samo u izuzetnim slučajevima, govore vrlo jasno o humanom pristupu ovog zakona i vrlo su dobre i za mlade ljude, kao buduća ljudska bića i stanovnike Kosova, i naravno za porodice koje su svakako zainteresovane za pitanje maloljetnika.

Razumem skepsu pojedinaca koji govore o teškoćama u primeni ovog zakona, posebno sa aspekta koje smo čuli od predstavnika Komisije i koje se tiču o pitanju posredovanja, potom nadgledanja u drugoj familiji, potom nedostatka sudija i sva ona druga pitanja koja se tiču teškoća u sprovođenju zakona, ali moram to istaći da to ne sme biti razlog da budemo vrlo ždušni u tome da podržimo ovaj zakon i da budemo vrlo uporni u tome i istrajni da sve nedostatke u primjeni zakona koji budu postojali, da nastojimo da rešimo ubuduće tokom razvoja kosovskih institucija pravosuđa i omogućavanja tih uslova. Ono što bih istakao ovde kao važnu stvar, možda sa jednog kulturološkog aspekta ili nekog drugog, možda je bio nedostatak u tome što se nije vodilo računa između razlike u fiziološkoj starosti i dobnoj starosti, tako da u našoj, da tako kažem, subkulturi o nasleđu koje mi imamo, termin „dijete do 18. godina“, mislim da nije sasvim prihvatljiv, s obzirom da se kod nas uglavnom tretira do 12 ili 15. godina, i trebalo voditi računa, dakle, i o tim specifičnostima koji pripadaju našem podneblju i našoj kulturi tradicije.

I na kraju bih istakao da, naravno, ima nedostataka vezano za stil koji su toliko nepremostivi da mjenjaju smisao zakona, recimo u članu 2. u prijevodu na srpskohrvatski jezik piše, tamo gde se određuju govori o mlađim maloljetnicima i starijim maloljetnicima. U oba slučaja kaže, dakle, ponavljam i za mlađe maloletnike i starije maloljetnike kaže: da su između 14. i 18. godina, a ustvari treba pisati za mlađe maloljetnike od 14. do 16. godina, i starije maloljetnike od 16. do 18. godina. To potpuno izvrće smisao Zakona i mislim da su to zaista, ovo sam nekoliko puta govorio i mislim da je krajnje vreme da ovi prjevodi ne zadiru samo u stil prevođenja i u kvalitet, nego i u činjenice, zakon dobija sasvim drugi smisao, te bih molio da se ovo ispravi i da zakon dobije onu formu koja je potrebna da bude. Toliko, to je stav i osobni moj i Grupe za integraciju i Zakon smatramo prihvatljivim i onaj koji treba glasiti. Hvala, ljepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka kërkuar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderur, zoti kryesues!
Ministra,
Deputetë,

Duke e mbështetur në parim, në përgjithësi disa vërejtje parimore që janë të rëndësishme së veçantë për t'i theksuar, që tani, nga kjo etapë. Fillimisht në gjuhën shqipe thuhet: "Kodi i drejtësisë për të mitur", menjëherë, ama menjëherë, në paragrafin e parë, në nenin e parë thotë: "Ky ligj", ka dallim ligji edhe kodi e tjera e tjera. Më pastaj në gjuhët tjera, po asisoj nuk ka konsistencë, po kësisoj është edhe në anglisht ku thotë: "Kod", a neni thotë "rislo" e qartë, ose në serbisht: "kodeks", këtu është thënë "kodeks", këtu thotë: "ovaj zakon". Më pastaj është teksti në, sidomos në serbisht-boshnjakisht, jashtëzakonisht i dobët, aq i dobët sa që është i pakuptueshëm. Nuk po e lexoj, konkretisht e marrim paragrafin e parë, te neni i parë është me të vërtetë tepër i dobët. Nuk bën kësisoj sepse, ju lutem, ndër të tjera, cenohen edhe të drejtat elementare të qytetarit që do, i duhet ta ketë ligjin e qartë dhe të shkruar mirë. Në përgjithësi ky dokument është i tillë dhe del se, ose e kanë bërë disa individë, ose eventualisht disa grupe të individëve, të cilët më pastaj nuk i kanë harmonizuar fare, po i kanë zgjidhur mekanikisht edhe ka ndërprerje në konceptin organik, kështu.

Te neni 1, paragrafi 12. Në një gjuhë thotë e thotë duhet të jetë ekspert gjykatësi, ekspert, ekspert është shkencëtari. Në anën tjetër, në gjuhën, po e zëmë në anglisht, thotë që duhet të ketë ekspertizë, a ekspertiza në anglisht e ka kuptimin të ketë përvojë. Kjo është edhe kësisoj edhe në serbisht, kështu që, ne duhet ta kem një, zoti kryesues, një ligj në të tri gjuhët, ama krejtësisht që të jenë adapt dhe jenë të përputhshëm, se ndryshe ne do t'i krijojmë tri rreze juridike, jo sisteme, që do të ishte tepër keq për neve se një shtet duhet ta ketë një rend juridik, sepse në Kushtetutë thuhet shprehimisht se ligji në cilindo gjuhë është i përditshëm, vlen si ligj, ai ligj dhe tash mund të ndodhin në praktikë shumë abuzime dhe shumë spekulime. Bie fjala, më konvenon mua, kjo dispozitë edhe thirren në atë dispozitë po e zëmë apo anasjelltas. Këto janë çështje substanciale.

Ju lutem, ka formulime me të vërtetë që nuk përkojnë as me gjuhën, as me terminologjinë, as me praktikën e nomoteknikës. Konkretisht, ka shumë. Unë i kam zgjedhur disa. Neni 5, ja si thuhet: "Dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit mbi, ligjit për, ekzekutimin e sanksioneve penale dhe të çdo ligji tjetër relevant" Si, po kjo shprehje është e patolerueshme e paakceptueshme, nuk mund ta gjejmë në asnjë gjuhë tjetër, ju lutem. Paska ligje relevante dhe paska ligje irelevante, kjo nuk ka kuptim kësisoj. Me të vërtetë kjo është tepër dobët.

Unë, nuk do ta kisha lejuar po të kisha qenë diku aty, në këtë hierarki, pa e lexuar njëherë prej fillimit deri në fund dhe janë disa lëshime tepër, si me thënë të rënda, se nuk është fjala për cikërrima, ose ju lutem te neni 7. 2 ky do të duhej të ishte i harmonizuar me nenin 2-shin edhe me 30, sepse është fjala për caktimin e dënimit ndaj të miturit, më pastaj përjashtimin... edhe më pastaj parashkrimi. Këto tri dispozita medoemos duhet të rishikohen edhe të riformulohen, që mos të jenë kolizive reciprokisht.

Është praktikë e keqe kjo, e keqe. Konkretisht, neni 15, ndërmjetësimi. E kemi Ligjin për ndërmjetësim që është ligj special "lex specialis derogat lex generalis", domethënë,

deshëm, nuk deshëm aplikohet përpara këtij. Me këtë, nuk do të duhej ndonjë dispozitë që do të bëhej një specifikë e veçantë e përndryshe jo të përshkruhen disa dispozita nga ai ligj, ju lutem se nuk ka nevojë. Kjo është një. Dy, kurrkund nuk lejohet, nuk praktikohet, se do të ishte praktikë e keqe që të thirret në ligjin, në ligjin, numrin edhe nenin, pse, sepse këto ndodhin në praktikë. Mund të ndryshohet, plotësohet e novelohet, modifikohet ai ligj, edhe më pastaj do të dilte dallash këtu puna, prandaj do të duhej l i vogël ligji, i referohet ligjit edhe më pastaj atje dispozitës përkatëse edhe do të duhej të ndryshohej kjo dispozitë për çështje teknike që nuk i kemi bërë si duhet me kohë.

Te neni 30, gjoba jo, po dënimi me të holla, alineja e fundit, ja ç' thotë: "Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri", me këtë dispozitë cenohet direkt pavarësia e gjyqësorit. Gjykata i merr përsipër e për bazë rrethanat lehtësuese, orientuese, të gjithë faktorët që influencojnë në lartësinë e dënimit edhe do të duhej ta caktonte me përgjegjësinë më të madhe lartësinë e dënimit, e do të ishte çështje e ekzekutimit ajo, se ka apo nuk ka e jo apriori që të harmonizohet. Nuk ka e tash duhet dënimi më i ulët, po duhet dënimi adekuat, adapt, më pastaj në ekzekutim ka rregulla për këtë çështje. Më pastaj ky bile thotë që posedon, posedimi është prona ekonomike që ka prona, ju lutem se posedim mund të jetë i ligjshëm, i paligjshëm e tjera e tjera. Do të krijoheshin baza, zotëri kryesues e kolegë të nderuar, baza juridike solide për t'i bishtëruar dispozitave të këtij dokumenti në këtë rast, të këtij kodi që është quajtur kod, edhe kod, nuk është edhe kod, nuk duhet të emërtohet, sepse nuk e rregullon krejt materien complete që u referohet të miturave. Përmbajtja e përcakton emërtimin se është fjala për Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale kundër të miturve e ndaj të miturve. Nuk është fjala për kod. Edhe përfundimisht, ju lutem e marr vetëm dispozitën e nenit 161. Ja si është hartuar: "Organet kompetente mund të nxjerrin akte nënligjore për zbatimin e këtij kodi", domethënë, kush janë ato organe kompetente njëherë? Shteg i hapur për komentime, nuk duhet me ligj bile së paku. Më pastaj, shkon fakultative, jo në imperative, mund, do të thotë, nëse duhen i nxjerrim po nëse nuk duhen nuk i nxjerrin edhe çka do të thotë, do të thotë se bie fjala është personi apo grupi i personave që është indolent, indiferent që nuk ia donë punën apo jo edhe e ka bazën juridike, s' ka obligim për t'i nxjerrë aktet nënligjore, pa akte nënligjore të caktuara, ligji nuk mund të aplikohet edhe nuk zbatohet akti më i rëndësishëm i shtetit e i Kuvendit, akti ligjor. Nuk ka akt as politik as juridik më të rëndësishëm se akti ligjor edhe do të thotë, ne do ta kishim bërë një ligj, mirë por një nëpunës civil apo le të jetë edhe gjykatës përmbarues për shkak të hirit të tij apo të saj, do ta kishte alibinë juridik. Mundet, do të thotë, prandaj, ju lutem është fjala se me amendamente vështirë po arrihen këto korrigjime, më pastaj po dalin shumë dokumente, më shumë projekt- amendamente në aktin ligjor se sa edhe dispozita që ka akti ligjor. Ka shprehje të rënda, gjykata nuk shqipton, ju lutem, mësuesja e këshillon nxënësin si duhet të shprehet. Gjykata cakton edhe në gjuhë tjera cakton apo jo. Më pastaj ligji nuk parashikon asgjë, por përcakton, përcakton, ka shprehje, madje përdoret herë gjyqtari, herë gjykatësi, nuk ka konsistencë që do të thotë shumë duar kanë punuar. Supozimi im i bazuar kanë punuar, më pastaj kanë kompilua mekanikisht pa një vështrim së paku kritik, abinicio, prej fillimit deri në fund. Ju falënderohem për dëgjimin.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Projekt-kodi i drejtësisë për të mitur, të cilën e ka sponsorizuar Ministria e Drejtësisë, është vërtet prezantim i një koncepti të ri në drejtësinë për të mitur e që ka të bëjë me konceptet më shumë të mbështetur në përmirësim, rehabilitim dhe jo në dënim.

Projekt-kodi për të mitur krijon kornizën ligjore në fushën e legjislacionit për të mitur. Me këtë projekt-kod kryhet sistem më efikas dhe më i avancuar i legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave elementare të miturve. Këtë e them duke e krahasuar me ligjin aktual i cili e ka, e rregullon këtë fushë, Ligji penal për të miturit. Megjithatë, nevoja për një projektligji të tillë, gjegjësisht projekt-kod të tillë është evidente për shkak se të dhënat sipas raportit të UNICEF-it, e të cilat të dhëna i ka bazuar ose i ka marr nga policia, tregojnë rritje të krimeve të miturve në Kosovë.

Projekt-kodi synon të sigurojë balancën në mes të kërkesave për mbrojtjen publike nga veprat penale, ofrimin të shërbimeve të përshtatshme për të miturit, të cilët janë ndeshur me ligjin dhe realizimit të kërkesave ligjore që çdo të mituri t'i sigurohet drejtësia. Pra, balancimin në mes kujdesit edhe mbrojtjes së fëmijëve dhe sigurisë publike. Janë përfshirë kryesisht katër parime themelore në këtë projekt-kod. E para është se të gjitha autoritetet e përfshira në hetimin e krimit dhe ndjekjen penale të shkelësve janë të lidhur me një detyrë, të merren sa më shpejtë dhe në kohën më të shkurtër të mundshme për të miturin.

Parimi i dytë është, parimi i trajtimit të miturve me kujdes të veçantë, duke respektuar të drejtat e tyre si persona të ndjeshëm. Parimi i tretë janë përpjekjet për të shmangur dënimet dhe paraburgimin për të miturin, por që këto të përdoren vetëm si masë e fundit. Parimi i katërt, është parimi i riedukimit dhe i mbrojtjes juridike dhe jetës private të miturit. Pra, ky projekt-kod promovon masat e diversitetit që promovojnë edukimin dhe mirëqenien psikologjike të të miturit. E reja në këtë, janë këto masa, masat e diversitetit, pra si masë parandaluese, siç është parandalimi i fillimit të procedurës ndaj të miturit që ka rënë në kundërshtim me këtë ligjin, parandalimin e sjelljes recidiviste, rehabilitimin dhe reintegrimin. Ndërsa, sa i përket masave edukative, ato duhet të sigurojnë edukimin dhe aftësimin profesional, duke e ndihmuar kështu rehabilitimin dhe ngritjen e përgjegjësisë të të miturit dhe duke i ndihmuar që ata të bëhen qytetarë të mirë dhe të përgjegjshëm. Megjithatë, në rastet kur të miturit i nevojitet një kujdes i veçantë, për shkak të çrregullimeve mendore ose të metave fizike, atëherë masa e cila caktohet nga gjykata është dërgimi i të miturit në institucion për kujdes të veçantë. Sfidë për këtë projekt-kod është zbatimi i dispozitave ligjore dhe sidomos i atyre të cilat kanë të bëjnë pikërisht me përkujdesjen dhe rehabilitimin e të miturve, realisht me masat parandaluese, jo vetëm që mungon, do të thotë, buxheti për Qendrën e Edukimit, që ka rëndësi të madhe, por unë kam edhe vërejtje të veçanta në nene të veçanta, siç është neni 41.2, e cila ka të bëjë me trajtimin e kryerësve të veprës penale në moshën 14 vjeçare dhe ku parashihen programe të veçanta.

Gjithashtu, nxjerrja e akteve nënligjore nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nuk është konsideruar këtu si çështje detyruese, prandaj duhet të konsiderohet si çështje detyruese dhe duhet të konsiderohej si çështje detyruese dhe duhet të caktohet koha e nxjerrjes së aktit nënligjor. Unë propozoj që kjo të bëhet 6 muaj pas nxjerrjes së këtij projekt-kodi.

Neni 43.6 thotë se të miturin mund ta përfaqësojë vetëm mbrojtësi i regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, konsideroj se kjo është kufizim i lirisë elementare të miturit për të zgjedhur mbrojtësin e vet.

Neni 51, detyra e Këshillit Gjyqësor për të caktuar gjykatën kompetente për shkallë të parë për të gjitha çështjet penale për të miturit, duhet të jetë detyruese. Ndërsa sa i përket masave edukative të cilat janë përfshirë në nenin 86.2 dhe nenin 87 e që parashohin programe individuale për të miturin, kam dyshimin se mund të zbatohen në praktikë dhe kjo paraqet një sfidë për ligjin.

Neni 121.2, thotë se të miturin ka të drejtë së paku një herë në muaj ta vizitojnë personat tjerë. Mendoj se duhet të definojë qartë se kush janë këta persona tjerë dhe në përgjithësi aktet nënligjore të cilat parashihen që të nxirren nga Ministria e Drejtësisë, duhet të kenë afatizimin kohor dhe propozoj që nxjerrja e këtyre akteve nënligjore nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, gjithashtu të bëhet, 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij projekt-kodi. Pra, projekt-kodi në përgjithësi nuk i cenon parimet e përgjithshme e të legjislacionit të BE-së edhe pse BE-ja më shumë e ka rregulluar çështjen që ka të bëjë me bashkëpunimin, çështjet penale. Meqë është ligj më i avancuar se ligji aktual dhe me kërkesën që të ndahet buxheti për zbatimin e këtij ligji, në parim e përkrah. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!
Edhe diskutimi i fundit është i deputetes Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Zotërinj ministra,

Zotërinj deputetë,

Drejtësia për të mitur është çështje e cila është analizuar në Raportin e Progresist të Komisionit Evropian për Kosovën, në pjesën e kriterëve politike dhe në të janë paraqitur disa sfida dhe rekomandime për këtë fushë, të kriterëve politike të Kopenhagës, siç janë: reintegrimi i të miturve në shoqërinë kosovare, pas kryerjes së dënimit, është çështje për t'u
brengosur.

Roli i shërbimit të dënimeve me kusht, ende nuk është kuptuar si duhet. Në bazë të ligjit i cili po aprovohet, prokurorët mund t'i qojnë të miturit që kanë bërë vepra penale drejt në shërbimet e dënimit me kusht, duke i anashkaluar gjykatat.

Mungesa e koordinimit në mes të strukturave qendrore dhe lokale, pengon implementimin e Kodit Penal për të mitur. Në përgjithësi, mbrojtja e fëmijëve mbetet e dobët. Duhet të bëhen përpjekjet e mëtejme që të garantohen të drejtat e fëmijëve,

kështu që miratimi i këtij projekt-kodi është një hap me rëndësi për Kosovën në procesin e integritimeve evropiane. Edhe pse në bazë të *acquis communautaire* nuk ka obligime që në këtë projektligj të inkorporohen direktivat dhe rregulloret e Unionit Evropian, megjithatë janë disa dokumente që kanë të bëjnë me këtë çështje në të dy organizatat, Unionin Evropian dhe Këshillin e Evropës.

Në Unionin Evropian është dokumenti i Komisionit për Ekonomi dhe Çështje Sociale, për parandalimin e delikucencës së të miturve, mënyra si të veprohet me delikucencën e të miturve dhe roli i sistemit të drejtësisë për të mitur në Unionin Evropian.

Në Këshillin e Evropës, rekomandimi numër 87/20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në reagimet sociale të delikucencës së të miturve. Nën 2, rekomandimi numër 20 i vitit 2003 i Komitetit të Ministrave për mënyrën e re të marrjes me delikucencën e të miturve dhe roli i drejtësisë për të mitur.

Draft-kodi për të mitur që po shqyrtohet sot, është i udhëhequr me këto parime, sistemi i drejtësisë për të mitur gjithnjë do të ketë parasysh mirëqenien e të miturit dhe që reaksioni ndaj tyre që janë të dëmtuar nga i mituri, do të jetë proporcional me rrethanat e të dyja palëve. Heqja e lirisë do të bëhet vetëm si masë e fundit dhe do të kufizohet për një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Gjatë kohës që nuk është në liri, i mituri do të ketë mundësi edukimi, përkrahje psikologjike dhe, nëse është nevoja edhe ndihmë mjekësore, që të lehtësohet rehabilitimi i tij. Këto principe themelore janë në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira në këtë fushë.

Miratimi i draft-kodit për të mitur, është një shkallë me rëndësi në procesin e integritimeve evropiane, në përmbushjen e kriterëve politike për stabilizim- asocim dhe arritjes së përputhshmërisë me praktikat më të mira evropiane në këtë fushë. Por, nëse i referohemi prapë vërejtjeve në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, miratimi i legjislacionit duhet të jetë fokusi dhe përqendrimi jonë me qëllim që të arrihen aspiratat tona për integrimin në Bashkësinë Evropiane. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e kërkon ministria Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Ju falënderoj të gjithëve për vërejtjet. Disa ishin vërejtje përmbajtjesore, disa ishin gjuhësore, disa nuk kishin lidhje me ligjin, por kishin me punën e gjyqësorit e tjera e tjera. Megjithatë, u ngrit me të drejtë këtu çështja e zbatimit të disa dispozitave të këtij ligji.

Unë jam plotësisht e vetëdijshme dhe apriori e thashë se nuk mund të zbatohen të gjitha dispozitat për mungesa financiare. Mirëpo, sikur ato të mos inkorporoheshin këtu, ato dispozita, atëherë do ta kishim një situatë tjetër, nuk do ta kishim një ligj në harmoni me ligjet e BE-së, dhe çka do të ndodhte, BE-ja do të na kthente ose do të na bënte vërejtje ose do të na kritikonte për një ligj të keq. Sido që të jetë, të krijojmë ligjin, ato dispozita që mund të zbatohen, po zbatohen me sukses dhe të miturit po i marrin ato masa të cilat janë të zbatueshme, kurse sa i përket numrit të gjyqtarëve,

prokurorëve, specializimit të tyre e tjera, ligji me to nuk merret. Ka të meta teknike, ka të meta gjuhësore, të gjitha këto mund të riparohen në shqyrtimin e mëtutjeshëm të këtij ligji, por dua t'ju them se, ndonëse në Qendrën Korrektuese dërgohen disa të mitur ndaj të cilëve janë të shqiptuara disa masa, ne jemi sidomos të vëmendshëm për të miturit, sepse aty kemi të angazhuar psikologë, pedagogë, kemi të angazhuar edhe mësimdhënës të cilët punojnë në shkollat publike dhe u japin të miturve edhe diplomat publike, në mënyrë që të mos mbetet asnjë gjurmë se një i mitur ka mbaruar shkollën në Qendrën Korrektuese. Gjembat janë, është e vërtetë, sepse aty është Qendër Korrektuese, kur është Qendër Korrektuese presupozon se ka të shqiptuar një dënim, mandej për shkak të Smrekovnicës që e kemi pas deri me tash të zënë, ne jemi detyruar që të dërgojmë aty edhe njerëz në paraburgim. Ajo është e keqe, mirëpo, tani Smrekovnicën e kemi të lirë edhe mund të bëhet, të eliminohen këto pengesa. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre!

Ju lutem bëhemi gati regjia dhe deputetët për ta votuar ligjin në parim. Në sallë kemi 70 deputetë. Përgatitemi për votim në parim të këtij projektligji.

Votojmë, tash.

Me 65 vota “për”, 2 abstenime dhe 1 “kundër”, votohet në parim projektligji.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione për punën e mëtutjeshme në ligj.

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitet, dhe
- Komisionin për Integrime Evropiane

Kalojmë në pikën e katër të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht**

(Ndërhyrje nga salla)

KRYESUESI: Urdhëro! Ju lutem shumë. Komisioni funksional del dhe jep mendimin. Kush është në emër të komisionit funksional që flet sot këtu?

(Reagime nga salla)

Është çështje tjetër. Ministri ka kërkuar. Kjo ka hyrë në... duhet të kemi argumentin pse e kthejmë si Kuvend. Urdhëro, zoti Maloku e ka fjalën. Urdhëroni, zonja Hetemi

ELHEME HETEMI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional në bazë të kërkesës së sponzoruesit, në këtë rast Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe në bazë të vlerësimeve që i ka bërë këtij

projektligji, propozon që ky projektligj të hiqet nga rendi i ditës së kësaj seance plenare....

KRYESUESI: T'i kthehet Qeverisë

ELHEME HETEMI:.. T'i rikthehet Qeverisë për ripunim ose hartim i ri i ligjit. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Deputetë të nderuar dhe zonjë e nderuar,
Unë po ndjek procedurat e pastra të Kuvendit. Komisioni i juaj ka kërkuar të ndodhë kjo, unë kërkoja artikullim të Komisionit. Tash e qes në votim mendimin e Komisionit që të kthehet ky projektligj.

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, domethënë, për kthim, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, votohet mendimi i Komisionit funksional që ligji të kthehet.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamente të propozuara. Raportet, me rekomandime të komisioneve i kanë deputetët. Pra se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor apo raportuesin e Komisionit që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Nëse do, nuk ka nevojë, nuk duan. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni Funksional sipas radhës së paraqitur. Në Kuvend kemi, ma jap numrin e saktë tash sa jemi brenda. Në sallë ka 69 deputetë. Fillojmë votimin e amendamenteve. Votojmë. Tash.

Amendamenti nr. 1

Me 62 vota “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër” kalon amendamenti 1

Amendamenti nr. 2

Votojmë, tash.

Votohet amendamenti nr. 2 me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim.

Amendamenti nr. 3

Votojmë, tash.

Votohet amendamenti nr. 3, me 62 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim.

Amendamenti nr. 4

Votojmë, tash.

Votohet amendamenti nr. 4 me 60 vota “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”

Ju lutem, 69 deputetë janë këtu. Votojmë për ligjin në tërësi me plotësimet e amendamenteve që sapo i votuam.

Votojmë, tash.

Ligji në tërësi kalon me 64 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin dhe kanë dhënë rekomandimet e veta.

Para se të procedojmë me votimin, ftoj përfaqësuesin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nëse ka të flas në emër të Komisionit. Nuk ka, atëherë, ju lutem, kalojmë në votimin e amendamenteve një nga një.

Amendamenti nr. 1

Votojmë, tash.

Me 61 vota “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 1.

Amendamenti nr. 2

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 2.

Amendamenti nr. 3

Votojmë, tash.

Me 56 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 3.

Amendamenti nr. 4

Votojmë, tash.

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, kalon amendamenti 4.

Amendamenti nr. 5

Votojmë, tash.

Me 50 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 5.

Amendamenti nr. 6

Votojmë, tash.

Me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, kalon amendamenti 6.

Amendamenti nr. 7

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, kalon amendamenti 7.

Amendamenti nr. 8

Votojmë, tash.

Me 58 vota “për”, 2 abstenime, 1 “kundër, kalon amendamenti 8.

Amendamenti nr. 9

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër, kalon amendamenti 9.

Amendamenti nr. 10

Votojmë, tash.

Me 59 vota “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 10.

Amendamenti nr. 11

Votojmë, tash.

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, kalon amendamenti 11.

Amendamenti nr. 12

Votojmë, tash.

Me 63 vota “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 12.

Amendamenti nr. 13

Votojmë, tash.

Me 61 vota 2për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, kalon amendamenti 13.

Amendamenti nr. 14

Votojmë, tash.

Me 59 “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 14.

Amendamenti nr. 15

Votojmë, tash.

Me 60 vota “për”, asnjë abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 15.

Amendamenti nr. 16

Votojmë, tash.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, kalon amendamenti 16

Amendamenti nr. 17

Votojmë, tash.

Me 58 “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër” kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 18, tash:

61 “për”, 1 abstenim, zero “kundër”, kalon amendamenti 18.

Votojmë amendamentin 19, tash:

62 “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 19.

Votojmë amendamentin 20, tash:

62 “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 20.

Votojmë amendamentin 21, tash:

63 “për”, zero “kundër”, 1 abstenim, kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 22, tash:

64 “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 23, tash:

61 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 24, tash:

60 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 25, tash:

63 “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 26, tash:

64 “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti.

Dhe, amendamenti i fundit, amendamenti 27, votojmë tash:

62 “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti i fundit 27.

Në sallë kemi 73 deputetë. Ju thërras që të votojmë Projektligjin në tërësi, bashkë me këta 27 amendamente që sa po i votuam.

Votojmë, pra, ligjin në tërësi, tash:

Ligji votohet me 67 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”.

Kalojmë në pikën e shtatë:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e amendamenteve.

Raportet me rekomandime i keni. Para se të procedojmë për votimin, ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësiror nëse do të japë mendime para votimit të amendamenteve. Nuk ka!

Unë shoh këtu një deputet që ka kërkuar fjalën, para se të nisim me votim. Zoti Naser Osmani, urdhëroni!

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Desha vetëm të tërheq vëmendjen që Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar amendamentet e komisionit funksional dhe ka ardhur në përfundim që nëse nuk shlyhet amendamenti i komisionit funksional që ka të bëjë me 0.3% të financimit vjetor, atëherë ky projektligj ka kosto të madhe buxhetore dhe si i tillë nuk mund të kalojë.

Prandaj, unë kërkoj nga deputetët që të përkrahet amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa, përndryshe ligji nuk ishte dashur të kalojë për arsye se krijon... Është fjala për amendamentin 13 të komisionit funksional. Si po duket, këtu është bërë një ngatërresë dhe kjo nuk figuron në amendamentin 13. Mirëpo, ky është kusht që të fshihet 0.3% të financimit nga buxheti për çdo vit.

KRYESUESI: Vetëm një moment, Naser! Nëse është kaq me rëndësi që është problem që nëse s'ndodh kjo, s'vlen as ligji dhe nuk zbatohet, atëherë të lutem saktësoje kur të mbërrijmë, në cilin amendament, atëherë bisedojmë dhe vendosim. Pra, cili është?

NASER OSMANI: Zoti kryesues, Raporti i Komisionit për Buxhet dhe Financa është shumë i saktë, shumë i qartë dhe thotë kështu: "Në amendamentin 13 të propozuar nga komisioni funksional, që i referohet nenit 17 paragrafi 1 pikë 1 të Projektligjit, komisioni rekomandon që të fshihet 0.3%, ndërsa në amendamentin 13 kjo nuk figuron. Si po duket, është bërë një gabim në administratë.

KRYESUESI: Mirë, faleminderit! Tash e ka kërkuar fjalën deputeti Maloku! Urdhëroni, zoti Maloku.

NAIM MALOKU: Unë i lus deputetët që kur të vijmë te amendamentet, atëherë le të paraqiten për fjalë për t'i kundërshtuar ose dhënë pëlqime për t'u miratuar. Amendamenti 13 nuk ka në përmbajtjen e tij 0.3%-shin të cilit i referohet deputeti Naser Osmani. Faleminderit!

KRYESUESI: Kur të vijmë te amendamenti, atëherë ne diskutojmë. Po vazhdojmë dhe po fillojmë me votime të amendamenteve.

Votojmë amendamentin 1, votojmë tash:
Votohet me 53 "për", 1 abstenim, asnjë "kundër".

Votojmë amendamentin 2, votojmë tash:
Kalon me 48 "për", 1 abstenim dhe asnjë "kundër".

Votojmë amendamentin 3, tash:
Kalon me 56 vota "për", 2 abstenime dhe asnjë "kundër".

Votojmë amendamentin 4, tash:
Kalon me 57 "për", 2 abstenime, asnjë "kundër".

Votojmë amendamentin 5, tash:
Kalon me 52 "për", 1 abstenim dhe asnjë "kundër".

Tash votojmë amendamentin 6.

Votohet me 51 “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”.

Votojmë amendamentin 7, tash:

52 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër” kalon amendamenti 7.

Votojmë amendamentin 8, tash:

49 janë “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, kalon amendamenti 8.

Votojmë amendamentin 9, tash:

Kalon amendamenti me 54 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”.

Amendamenti 10, tash:

Me 55 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, kalon ky amendament.

Amendamenti 11. Votojmë tash:

Kalon me 55 “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”.

Votojmë amendamentin 12. Votojmë tash:

Amendamenti 12 kalon me 57 “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”.

Tash jemi te amendamenti 13. Për fjalë është paraqitur Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne kur kemi filluar amendamentimin e këtij projektligji, natyrisht, duke pasur parasysh që edhe tani ekzistojnë disa donacione në lidhje me përgatitjen e këtyre programeve, kemi pas menduar se duhet të jetë një fond dhe ka qenë propozim që të jetë, do të thotë, deri në 0,3%, por pasi Komisioni për Buxhet dhe Financa ka thënë që kjo do të ketë implikime buxhetore dhe nuk mund të kalojë, pastaj komisioni ka marrë vendim që të eliminohet ajo dhe të mbetet siç është neni 13. Do të thotë, nuk ka asnjë problem, sepse komisioni edhe një herë e ka rishqyrtuar kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe drafti final është ky që është tani këtu. Domethënë, është eliminuar.

KRYESUESI: Do të thotë, ti kërkon që të votohet ky formulim që ekziston dhe nuk prodhon diçka tjetër.

Mos folni me hamendje. Fjalën e ka kërkuar Zef Morina, foli. Tani, Elheme Hetemi. Urdhëro!

ELHEME HETEMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Propozoj që amendamenti të votohet sepse nga komisioni funksional, nga rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa është përmirësuar ajo dhe në nenin 19 nuk figuron më 0.3%-shi. Do të thotë, amendamenti duhet të votohet, sepse janë përfillur rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa që paraqiten komplikime financiare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë, zonjë!
Mua tash më mbetet vetëm të vazhdoj me votimin.
E vë në votim amendamentin 13 dhe votojmë tash:
Kalon amendamenti me 51 votë “për”, 3 “kundër” dhe 4 abstenime.

Vazhdojmë. Amendamenti 14. Votojmë tash:
Kalon me 55 “për”, zero “kundër”, 1 abstenim.

Votojmë amendamentin 15, tash:
57 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, kalon.

Amendamenti 16. Votojmë tash:
57 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 17, tash:
50 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, kalon amendamenti.

Votojmë amendamentin 18, tash:
Kalon me 53 “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”.

Votojmë amendamentin 19, që është edhe i fundit. Votojmë tash:
Ky amendament votohet me 54 “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”.

Në sallë tash kemi 70 deputetë. Kërkoj nga ju që të bëheni gati ta votojmë këtë ligj në tërësi, bashkë me amendamentet që sapo i votuam dhe votojmë tash:

Pra, Projektligji për financimin e programeve të veçanta të banimit votohet me 52 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”.

Pushim deri në orën 14,30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI SABRI HAMITI: Zotërinj kolegë deputetë të Kuvendit, ju lutem uluni se do të vazhdojmë punën.

Pika e tetë e rendit të ditës është:

- Propozim-Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2010

Propozim-Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2010 është hartuar në bazë të Strategjisë legislative të Qeverisë për vitin 2010, të Planit të punës së komisioneve parlamentare për vitin 2010, të Planit të veprimit të Kuvendit si dhe të Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2010.

Me qëllim të planifikimit, të organizimit dhe të mbarëvajtjes së punës të Kuvendit dhe organeve të tij, Kryesia e Kuvendit i propozon seancës plenare miratimin e Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2010.

Nuk kam paraqitje të kryetarëve të komisioneve parlamentare. Nuk kam paraqitje të Qeverisë. Atëherë, fillojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zoti Ramë Buja, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

RAMË BUJA: Zoti kryesues,
E nderuar zonja ministre, edhe ti që ke mbetur këtu,
Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka parë me vëmendje Propozim-Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2010 dhe natyrisht se e përkrahim si të tillë, por për ta bërë akoma më të begatë këtë gjë dhe duke parë nevojat dhe domosdonë që legjislacioni i Kosovës të pasurohet akoma më shumë dhe në disa fusha gjithsesi me urgjencë, atëherë kam edhe propozime shtesë.

Në fushën e qeverisjes së mirë, propozoj që të shtohet në agjendë:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/12 për qasje në dokumentet zyrtare;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03-L/134 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare dhe
- Ligji mbi zgjedhjet qendrore.

Në fushën e zhvillimit ekonomik kam këto propozime për projektligjet që të futen sa më parë në agjendën e Kuvendit:

- Projektligji mbi energjinë;
- Projektligji mbi Rregullatorin e Energjisë;
- Projektligji mbi rrymën dhe
- Projektligji për Bankën Qendrore.

Po ashtu, kam propozim për fushën e decentralizimit:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Ndërsa, tek fusha e sundimit të ligjit janë 11 projektligje që duhet të futen në agjendën e Kuvendit për vitin 2010:

- Projektligji për gjykatat;
- Projektligji për Këshillin Gjyqësor,
- Projektligji për Këshillin Prokurorial,
- Projektligji për prokuroritë publike,
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal,
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale,

- Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve,
- Projektligji për pengimin e pastrimit të parave dhe pengimin e financimit të terrorizmit,
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,
- Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve dhe
- Projektligji mbi kontrollimin e eksportit.

Me këto plotësime ne gjithsesi do ta përkrahim dhe japim kontributin tonë për të gjitha këto projektligje për t'u bërë ligje në këtë Kuvend të Republikës sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buja!
Për LDK-në flet Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!
Unë po besoj se keni një besim të madh se unë me të vërtetë do t'ia qëlloj kur të flas, sepse nuk kam qenë i paraparë, por sidoqoftë....

KRYESUESI: Ti, vetë ke qejf të jesh i paraparë!

EQREM KRYEZIU: Sidoqoftë, ne si Grup Parlamentar besoj se do ta kemi konsensusin që na mjafton edhe kjo ofertë e begatë e këtyre projektligjeve për këtë periudhë. Do të bëja, gjithashtu, në pajtim me Grupin tim Parlamentar, madje edhe më gjerë, një vërejtje që po rrinë në top-listë një kohë të gjatë - Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Sikur të ishim në gjendje me të gjitha forcat tona objektive e subjektive, madje jo vetëm këtu në Parlament, po edhe më gjerë, që ta heqim nga top-lista, unë do të isha shumë i lumtur dhe besoj se do të ishte një arritje e madhe edhe politike, madje edhe sociale, kisha për të thënë, për Parlamentin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeziu!
Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, cili është, kush e do fjalën? Deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!
E nderuara ministre,
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,
Programi i Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2010 është i domosdoshëm për planifikimin e aktiviteteve të Kuvendit dhe mbarëvajtjen e punës së Kuvendit. Në fund të fundit, kjo është e caktuar edhe me Rregullën 6 të Rregullores së Punës.

Është e qartë se nga Programi, pjesa më e madhe e punës së Kuvendit është e bërjes së ligjeve dhe unë, së pari, do të fokusohem në këtë.

Konsideroj se është një program ambicioz, meqenëse janë paraparë 146 projektligje të reja, prej të cilave 33 janë projektligje për ndryshim dhe plotësim, si dhe janë 23 projektligje të bartura nga viti 2009.

Duke marrë parasysh se sa është zbatuar programi i vitit 2009 dhe ligjet të cilat janë zbatuar, ose sa është zbatuar Programi i Punës i vitit 2009, unë propozoj që pasi Kryesia e Kuvendit është mbikëqyrëse e këtij programi të punës, atëherë edhe ajo të bëjë mbikëqyrjen, por edhe raportimin Kuvendit – seancës së Kuvendit të Kosovës për nivelin e përmbushjes së programit të punës, ngase dihet se nga ligjet e parapara në vitin 2009, diku, s’di as 30% a janë përmbushur. Prandaj, konsideroj se kjo punë duhet të bëhet dhe Kryesia ta bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të programit, të plotësimit të Programit të Punës dhe t’i raportojë Kuvendit.

Gjithashtu, një çështje tjetër është edhe vetë roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e Qeverisë. Nga ky program shohim se nuk ka shumë aktivitete sa i përket mbikëqyrjes së Qeverisë. Konsideroj se këto aktivitete duhet të shtohen dhe sidomos aktivitetet për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe nivelin e zbatimit. Meqenëse Qeveria gjithashtu është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, atëherë duhet Qeveria të raportojë para Kuvendit të Kosovës lidhur me nivelin e zbatimit të ligjeve. Gjithashtu, komisionet duhet të shtojnë aktivitetin e tyre monitorues të zbatimit të ligjeve, sepse nuk kam parë që ka shumë aktivitete të komisioneve për raportimin e zbatimit të ligjeve, gjegjësisht të monitorimit të zbatimit të ligjeve, prandaj mendoj se edhe ajo duhet shtuar.

Në aspektin legjislativ, nuk shihet në Program të Punës se është Rregullorja e re e Punës. Nuk e di si e ka planifikuar Kryesia, mbase mund të jetë edhe një sqarim, por mendoj se këtij programi të punës duhet t’i shtohet edhe Rregullorja e re e Punës.

Në çështje fund e kam edhe në faqen 29, pika 137, ku thotë Projektligji për pyjet. Parashihet që sponzorizuesi Projektligjin për pyjet ta sjellë në Kuvend në dhjetor 2010, kur do të bëhet në të vërtetë shqyrtimi i parë, kurse shqyrtimi i dytë është zbrazët. Kurse ne sot, posa e kaluam plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për pyjet. Nuk e di a është ndonjë gabim apo ka ndonjë sqarim, apo Qeveria parasheh prapë ndonjë ligj të ri në fund të këtij viti.

Në parim, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet me vërejtjet e cekura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Sylja!

Në emër të Grupit të AKR-së, anëtar i Kryesisë, Ibrahim Gashi!

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Gashi,

Sigurisht se ministrat tjerë në këtë pikë të rendit të ditës s’janë shumë të domosdoshëm të jenë këtu, se ne po debatojmë për agjendën e Kuvendit, jo të Qeverisë kësaj here.

Por, pa dyshim që kjo agjendë e punës së Kuvendit është e lidhur ngushtë me agjendën legjislative që e ka propozuar Qeveria e Kosovës dhe ndoshta do të ishte mirë që me vërejtjet që bëhen këtu, t'i korrigjonin ata propozimet e tyre, sepse kryekëput agjenda jonë është e determinuar prej projektligjeve që na vinë nga sponzorizuesit. Dhe, ndërlidhur me këtë, unë i kam disa sugjerime. Në parim, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet, është punë e përbashkët që e kemi bërë edhe në Kryesinë e Kuvendit, por që mund të modifikohet për t'u bërë më funksional dhe më i efektshëm në disa pika.

E para, mendoj unë që dinamika e shqyrtimit të projektligjeve, të shqyrtimit të parë të projektligjeve për muajin mars dhe prill është shumë e ngjeshur. Kemi 25 projektligje që duhen shqyrtuar brenda këtyre 2 muajve.

E dyta, Kam vërejtje te dy ligje, e vërejtje tjera nga fushat që lidhen me vokacionin e secilit prej nesh mund të kenë edhe kolegët e mi. Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm na vijë në një fazë, domethënë në pjesën e fundit të vitit dhe, si të tillë, në shtator është paraparë leximi i parë, në nëntor leximi i dytë dhe, si të tillë, do të thotë ato dy ligje s'mund të fillojnë të implementohen deri në fillimin e vitit tjetër shkollor, që i bie të vitit shkollor shtator 2011. Dhe, ndoshta do të ishte mirë që Ministria e Arsimit këto dy ligje t'i procedonte më herët në mënyrë që ato për fillimin e vitit shkollor dhe akademik 2010-2011 t'i kishim të gatshme si ligje, sepse edhe ashtu në këto dy fusha është vërejtur se kanë defekte ligjet ekzistuese, prandaj edhe është dhënë ky propozim për plotësim dhe ndryshimin e tyre.

Dhe, diçka tjetër që vërehet këtu dhe që u tha nga parafolësja, angazhimi i Kuvendit në plotësimin e misionit të tij të dytë që e ka në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, mendoj që ka një mungesë në parashikimin e aktiviteteve të tilla, e ne kemi konstatuar në Raportin tonë të punës për vitin e kaluar se kjo ka qenë pjesa, ndoshta, ku kemi çaluar më shumë, si Kuvend, për derisa në pjesën e aprovimit të legjislacionit, që ka ardhur këtu, kemi qenë ndoshta, kemi ecur me një dinamikë deri diku të kënaqshme. Kjo është pjesa ku nuk kemi pasur..., kemi pasur 2-3 aktivitete gjatë tërë vitit të kaluar dhe prapë në njëfarë mënyre frikohemi që të parashohim aktivitete të tilla në këtë vit, gjë që nuk është mirë.

Në parim, thashë, Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet dhe do të japë kontributin në realizimin e kësaj agjende dhe në modifikimin e saj edhe me kontribut konkret, nëse ka nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Para se t'ia jap fjalën zotit Lulzim Zeneli, shef i Grupit të LDD-së, vetëm desha t'ua tërheq vërejtjen kolegëve që të përpiqen të jenë shumë konkret, sepse ky është dokument që kalohet me një lexim, nuk do të ketë dy lexime ky program i punës, kështu që kujdesuni të bëni propozime krejt konkrete, të evidentohen në mënyrë që, në fund, t'i votojmë. Zoti Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pikërisht duke pasur për bazë se kemi të bëjmë, siç e potencuat edhe ju, me një lexim dhe nëse e vlerësojmë dokumentin që e kemi për bazë, atëherë Kuvendi i Kosovës, respektivisht Kuvendit të Kosovës i atribuohet vetëm roli ligjvënës dhe jo përfaqësues.

Duke ditur se një program i tillë, çfarë ne po pretendojmë të jetë, nuk përmban, do të thosha, elementet kryesore bazë të një programi të punës të një institucioni më të lartë, siç është Kuvendi i Kosovës.

Kemi të bëjmë me një plan legjislativ, që në këtë kuptim është në rregull, mirëpo duke pasur për bazë që Kuvendi i Kosovës ka edhe një rol më të madh, atëherë vetvetiu duhet të trajtohen seriozisht raportet apo llogaridhënia e organeve dhe agjencioneve apo të trupave që ky Kuvend i ka ngritur dhe do të duhej të përfshihej në programin e punës. Këtu nuk janë specifikuar, janë specifikuar me një term të përgjithshëm në hyrje të këtij dokumenti, që nuk është e mjaftueshme.

Ajo çka që si propozim duhet të jetë në planin legjislativ, si propozim i Grupit Parlamnetar të LDD-së, ka të bëjë me ligjet për privatizimin. Ne, si Grup, konsiderojmë se Ligji për privatizimin e Koorporatës Energjetike të Kosovës, Ligji për privatizimin e Postës, Ligji për privatizimin e resurseve natyrore – duhet të jenë të përfshirë gjithsesi në planin legjislativ, se kemi të bëjmë me objekte kapitale.

Çështja tjetër që duhet padyshim të jetë, është miratimi i Rregullores së Punës. Do të thotë, ne ende vazhdojmë me Rregulloren e vjetër dhe është bërë kjo një serial, do të thosha në veti, miratimi i këtij dokumenti.

Prandaj, duke mos potencuar çka thotë dinamika e implementimit të planit legjislativ, që duhet të rishikohet, ne konsiderojmë se ky plan i punës legjislativ duhet të plotësohet me këto ligje kapitale, duke mos potencuar edhe një herë – Ligjin për zgjedhjet, që është aq i nevojshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Zeneli! Për Grupin 7+, Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Mi takođe u principu prihvatamo Predlog zakona, uvažavajući sve propuste koji su nastali odlaganjem nekih važnih zakona. Znači, mi smo mišljenja da tu treba izvršiti neke korekcije kako bi neki prioritetni zakoni bili prije nego je dato u ovom predlogu, tako da u ostalom se slažemo sa ostalima. Mi u načelu prihvatamo, uz ovu primedbu koju sam naveo. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Murati. Për SLS-në, a ka kush? Nuk ka. Për Grupin për Integritet? E ka fjalën Vezira Emrush, deputete. Urdhëroni!

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč! I mi kao Grupa u celosti podržavamo ovaj program i dajemo do znanja da se u samom programu nalaze jako vitalne tačke i zakoni na koje moramo da obratimo pažnju i da vremenski ispunimo rokove koji su nam dati od strane Komisije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Nuk ka më në emër të grupeve. Fillojmë me deputetët. Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryesues! Unë e kam analizuar Propozim-Programin e Punës të Kuvendit për vitin 2010 dhe i kam disa vërejtje konkrete. Kam vërejtje në kohën kur parashihet të bëhet shqyrtimi i parë i disa projektligjeve dhe këtë shqyrtim e konsideroj të vonshëm. Ka të bëjë me Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, është numër 135 faqe 29. Shqyrtimi i parë parashihet në dhjetor të vitit 2010, derisa shqyrtimi i dytë dhe hyrja në fuqi me siguri do të jetë në vitin 2011 dhe konsideroj se është paraparë shumë vonë ky projektligj të shkojë në shqyrtimin e parë dhe është mirë që i njëjti të jetë në periudhën e parë, do të thotë deri në muajin korrik, duke ditur që në gusht ne veç jemi në pushim.

Pastaj, në faqen 25, numri 116 - Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës, propozohet shqyrtimi i parë në nëntor 2010, që do të thotë njësoj si ky projektligji i mëparshëm që e përmenda, duhet të hyjë në fuqi dhe leximin e dytë në të vërtetë ta kemi në 2011 dhe të hyjë në fuqi në vitin 2011, që konsideroj se është i vonshëm.

Për Projektligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë, thuhet: (në pritje të deklaratës financiare nga MEF-i), derisa nuk caktohet shqyrtimi i parë, thotë 2010, datë nuk ka. Shqyrtimi i dytë, thotë, 2010, datë nuk ka, që për mua është e papranueshme. Duhet të ceken datat dhe kjo deklaratë e MEF-it është mirë të mos vonohet, do të thotë të bëhet sa më herët, sepse kemi të bëjmë me të burgosurit politikë.

Pastaj, Projektligji për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, gjithashtu është paraparë të bëhet shqyrtimi i parë në dhjetor të vitit 2010 dhe konsideroj se është i vonshëm.

Pastaj, duke marrë parasysh gjendjen e pyjeve në Kosovë, Projektligji për pyjet, faqe 29, pika 137, parashihet shqyrtimi i parë në dhjetor 2010, që mendoj se ishte dashur të jetë më herët shqyrtimi i parë i këtij projektligji.

Gjithashtu, duke i marrë parasysh mbeturinat, qysh janë te ne në Kosovë, Projektligji për mbeturina, parashihet shqyrtimi i parë në tetor 2010. Për të njëjtin konsideroj që kishte qenë mirë të ndërmerren masa më herët dhe të kalojë shqyrtimi i parë më herët, gjithashtu, edhe i dyti dhe të hyjë në fuqi e të veprojmë sipas ligjit. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala. Po, çka të ndodhi ty? Atëherë, e ka fjalën deputetja Edita Tahiri!

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë po ashtu i bashkëngjitëm përkrahjes për Programin e Punës së Kuvendit të Kosovës për periudhën 2010, por kisha dashur të shtoj disa çështje që mendoj se i mungojnë këtij programi. E para, nga zbërthimi shihet vetëm roli i Kuvendit si ligjvënës, që është e vërtetë, por mungojnë edhe dy komponente tjera, e para – puna jonë, pra, që na takon si mbikëqyrës demokratik të punës së Qeverisë dhe një vargu të organizatave publike dhe të pavarura dhe, edhe një detyrë të re e kanë tashmë parlamentet botërore, përfshirë edhe Parlamentin tonë, që është diplomacia parlamentare. Për këto dy fusha unë

nuk po shoh asnjë aktivitet të evidentuar. Do të kisha propozuar që raportimet nga organizatat publike të bëhen në mënyrë të rregullt, ndoshta në fillim të vitit, pra të caktohet një afat apo një muaj i caktuar në fillim të vitit, ku të gjitha organizatat publike pak a shumë e kanë një orientim se kur është koha të raportojnë para Kuvendit të Kosovës. Kjo do t'u jepte atyre një përgjegjësi më të madhe dhe një ndjenjë të llogaridhënies ndaj Kuvendit të Kosovës, për shumicën e të cilave ky Kuvend është themelues i tyre.

Për sa i takon diplomacisë parlamentare, unë kam përshtypjen se Kuvendi i Kosovës zhvillon një diplomaci parlamentare pasive dhe zakonisht iu përgjigjet ftesave që vijnë nga institucionet e ndryshme homologe për vizita. Mendoj se duhet të ndërrohet strategjia dhe Kuvendi i Kosovës të bëjë një diplomaci parlamentare pro aktive, duke planifikuar edhe vetë vizita të ndryshme në parlamentet e botës, veçanërisht duke marrë parasysh nevojën për shtimin e veprimtarisë sonë për lobizime.

Po ashtu, në kuadër të diplomacisë parlamentare unë mendoj se Kuvendi i Kosovës, megjithatë, pavarësisht që Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës apo e Parlamentit Evropian, ne duhet të gjejmë mënyrat që të jemi prezentë në seancat e rregullta vjetore të këtyre institucioneve e të tjera, që janë si Asambleja Parlamentare e OSBE-së e të tjera, sepse duke qenë në status vëzhguesi dhe kjo është e mundur të bëhet, ma merr mendja se ne tashmë fillojmë procesin e integriteteve në institucionet parlamentare ndërkombëtare, në mënyrë që kur të ndodhë anëtarësimi i Kosovës, ne tashmë do të bënim një përvojë të duhur në këtë drejtim. Pra, mendoj se me këto që sugjerova duhet të plotësohet ky program dhe, natyrisht, të konfirmohet roli i Parlamentit si ligjvënës, si mbikëqyrës i punës së Qeverisë dhe si një mekanizëm që zhvillon diplomaci parlamentare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Tahiri! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli!

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të respektuar ministra,

Kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Me plotësime e përkrah Programin e Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2010. Kur them me plotësime, para së gjithash e kam fjalën për përfshirjen në këtë program të punës edhe të Projektligjin për ndryshimin e Ligjit numër 02-L/2 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe të pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe të familjeve të viktimave civile të luftës.

Me këtë projektligj rregullohet statusi i dëshmorëve të vrarë nga pushtuesi gjatë viteve '80 në përpjekje të armatosura, në burgje dhe në demonstrata. Bëhet fjalë për rreth 170 persona – raste si dhe 3 raste para këtyre viteve, për të cilat ka dokumentacion të qartë.

Amendamentet konkrete për këtë projektligj, të nënshkruara nga mbi 60 deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë dërguar në Kuvend vitin e kaluar, më 30 prill 2009. Siç dihet, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datën 19 maj 2009, ka kërkuar mendimin e Qeverisë. Jashtë çdo afati kohor, nuk është reaguar fare në këtë kërkesë. Nuk besoj se

lënia pa përgjigje gjatë gjithë kësaj kohe është jashtë detyrimit ligjor. Në kalendarin e punës së Kuvendit të Kosovës për muajin janar 2010 që e ka sjellë Kryesia, që është përfshirë në punën e Kuvendit për vitin 2010, mund ta shohim shkresën e 25 janarit 2010, është përfshirë në punime të Kuvendit për këtë vit projektligji për të cilin po flasim. Ndërsa, tash në këtë programin e punës që ka ardhur këtu, që na është shpërndarë dhe që po e shqyrtojmë tash, ky ligj nuk është përfshirë. Mund të supozohet se kjo është bërë për shkak se Qeveria nuk ka dërguar ende asnjë shkresë, siç është kërkuar nga Kuvendi, por kjo nuk do të thotë se ndërkohë Qeveria nuk dërgon përgjigje për të vazhduar procedimi i ligjit në fjalë. Prandaj, ju kisha lutur, ashtu si e tha kryesuesi, që ne të votojmë, është një propozim konkret të cilin e dhashë. Për tjerat ligje u fol këtu dhe nuk dëshiroj t'ia marrë kohë Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Xhemajli! Fjalën e ka deputetja Sanie Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Propozim-programi i punës që sot po e shqyrtojmë, si dokument bazë, do ta vlerësoja vetëm si plan legjislativ të Kuvendit, i cili kryesisht ka për bazë Strategjinë legjislative të Qeverisë, sepse në vete përmban 133 projektligje dhe 13 raporte që duhet t'i prezantojnë institucionet dhe agjencitë e pavarura në Kuvend.

Programi i Punës së Kuvendit theksohet se është bazuar në Planin e punës së komisioneve, e për çudi, asnjë objektiv i këtij programi të punës së Kuvendit nuk e prezanton punën e komisioneve.

Duke u nisur nga pasqyra shpjeguese e këtij projekt-programi, si Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare caktojnë agjendën e seancës plenare të martën e parë dhe të tretë të muajit, ndërsa seancat plenare mbahen të enjten dhe të premten e dytë dhe të katërtën e muajt, vlerësoj se jetësimi dhe zbatimi i këtij programi të punës së Kuvendit për vitin 2010, me tempin aktual të punës do të jetë vështirë i realizueshëm. Këtë e bazoj në faktin se dinamika e realizimit të këtij programi realizohet në bazë të kalendarit vjetor 2010 që, ndër të tjera, obligon deri në shtator në Kuvend të procedohen në lexim të parë 95 projektligje, që në shikim të parë është për t'u dëshiruar, por po të bëjmë ne krahasim me vitin e kaluar, deri në fund të shtatorit janë realizuar vetëm 14% të planit legjislativ. Jam skeptike që program do ta përmbushim.

Ajo çka vlen për t'u theksuar, se me punën e Kuvendit në drejtim të përmbushjes së standardeve dhe të rekomandimeve të Komisionit Evropian, të shprehura në Raportin e progresit, që ndër të tjera duhet të jetë edhe në programin e punës, janë: Kuvendi që nga janari i vitit 2008, kur është mbajtur seanca konstituive e legjislaturës së tretë, e cila vazhdon punën edhe sot, Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka miratuar Rregulloren e Punës, ndërkohë punën e tij e bazon në Rregulloren e Punës së legjislaturës së kaluar. Prandaj, propozoj që këtij projekt-programi t'i paraprijë miratimi i Rregullores së Punës.

Thuhet se programi është bazuar në Planin e Punës së Kuvendit për integritet evropian për vitin 2010. Kjo qëndron pjesërisht, se në këtë program nuk përfshihen fare 3

projektligje shumë të rëndësishme që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve kryesore të Kosovës. Unë propozoj që të përfshihen edhe këto projektligje:

- Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, që veç kalon nga legjislatura e kaluar;
- Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe
- Projektligji për qyteti e Prishtinës, që fare nuk parashihet, e ka qenë veç në vitin e kaluar. Ky është një lëshim që ne nuk guxojmë ta bëjmë.

Programi i Punës nuk parasheh në asnjë objektiv shqyrtimin e Raportit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, shqyrtimin e programeve dhe të strategjive zhvillimore që duhet të përcillen me plane veprimi për zbatimin e tyre, shqyrtimin e Programit të Qeverisë për barazi gjinore, që është shumë me interes për mua, individualisht, dhe për gjysmën e popullatës së Kosovës.

Kurse sa i përket raportit Qeveri – Kuvend, do të potencoj se ministrat nuk kanë qenë të përgjegjshëm për sa i përket pjesëmarrjes në seancat plenare dhe nuk u janë përgjigjur pyetjeve parlamentare dhe ftesave për të raportuar në komisione. Asnjë objektiv në program nuk përshkruan punën për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Asnjë objektiv në program nuk prezanton raportin e deputetit me elektoratin.

Dhe, krejt në fund, me një shpresë shumë të madhe këtë program e miratoj, në parim, me vetë faktin që ky projekt-program është bazuar edhe në Planin e Punës së Kuvendit për integritet evropian për vitin 2010, që lë shpresë për funksionimin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Por, vetëm me një dëshirë të madhe që të rritet dinamika e punës së Kuvendit, se për ndryshe as 30% s'do të mund t'i realizojmë me këtë temp të punës. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti i pavarur, Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryesues! Unë i dëgjova me vëmendje të gjithë parafolësit, por unë dua të ndalem në diçka çka kam vërejtur në këtë Projekt-Propozim të Punës së Kuvendit për 2010. Këtu kemi 135 ligje, që quhen ligje dhe projektligje për këtë çështje, prej tyre kam konsideruar që rreth 80 janë ligje që janë miratuar nga legjislaturat e kaluara dhe vetëm 33 prej tyre quhen ligje për plotësime dhe ndryshime, ndërsa 56 tjera nuk figuro se janë në procedurë për ndryshim dhe plotësim. Thjeshtë, këtu as gjysma e këtyre ligjeve nuk janë ligje të reja që vijnë në këtë Kuvend të Kosovës, prandaj kërkesa ime është që përveç që të ndahen nga prioritetet që duhet të respektohet edhe plani i veprimit për partneritet apo integritet evropian, duhet të saktësohen në këtë plan të veprimit se cilat janë ligjet e reja që i kanë ardhur këtij Kuvendi, cilat janë projektligjet që do t'iu nënshtrohen ndryshimeve dhe plotësimeve dhe të gjitha këto të sqarohen, sepse mund të konsiderohet një mashtrim optik, kështu të them, nga leximi se Kuvendit për një vit po miraton diku nga 140 ligje, që nuk është e vërtetë sepse shumica e ligjeve që unë i kam parë, janë ligje që janë miratuar në legjislaturat e kaluara dhe këtu nuk figuron që do të ndryshohen dhe plotësohen. Për shembull, unë do t'i marr disa: Projektligji për statusin e të drejtave të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, të veteranëve dhe

pjesëtarë të UÇK-ës, të familjeve dhe të viktimave civile e tjera, do të thotë është ligj që është miratuar dhe mund të ndryshohet, por duhet të ceket se është për ndryshime e plotësime. Mandej Ligji për markën tregtare, dizajnin industrial, patentat, sizmologjinë meteorologjinë, energjinë, rregullatorët – të gjitha janë ligje që janë miratuar më herët dhe kjo duhet të ceket se janë procedura të ndryshimeve.

Ndërsa, sa i përket çështjes së ndryshimeve dhe plotësimeve, ne duhet të jemi të kujdesshëm që ndryshimet dhe plotësimet të mos e dëmtojnë esencën e legjislacionit i cili është miratuar në legjislaturat e kaluara. Në rast se kuptohet ndryshim-plotësim që i ndërrohet emri nga UNMIK në institucionet e Kosovës, Qeveria apo Kuvend, ajo është në rregull, por nuk është ndryshim themelor me të cilin konsideroj se duhet të krenohemi ne me punën që e kemi bërë në fushën e legjislacionit. Dhe, çdo ndryshim e plotësim që propozohet nga ekzekutivi, nga ministritë respektive, mendoj duhet të jetë një sqarim pse iniciohet ndryshimi i atyre amendamenteve që Kuvendi të mos jetë i lajthitur dhe të mos ketë vështirësi, se në rast se angazhohemi për të përmirësuar legjislaturën në pajtim të direktivave evropiane, atëherë është në rregull. Ne kemi pasur disa raste që legjislacioni është dëmtuar me disa amendamente që kanë ndodhur, qoftë për hatër të ndonjë ministri ose ndonjë ministrie dhe kjo mendoj që nuk duhet të ndodhë dhe duhet pasur shumë kujdes ku hyhet në ndryshime dhe plotësime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Dugolli! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës në një farë forme është agjenda e punës sonë si njerëz të zgjedhur në organin më të lartë përfaqësues të vendit. Janë përfshirë disa ligje të rëndësishme të cilat mbulojnë shumë fusha që deri më tani nuk kanë qenë të rregulluar me ligj. Sipas meje, është një program tejet ambicioz, qoftë në aspektin e ligjeve të reja dhe të atyre që priten të plotësohen dhe të ndryshohen, që rrumbullakon shifrën prej 146 projektligjeve, do të thotë, me disa plotësime dhe ndryshime të ligjeve që janë votuar në legjislaturat paraprake. Mirëpo, unë konsideroj që në një farë forme agjenda legjislative e Kuvendit të Republikës së Kosovës po diktohet kryekëput nga sponsorizimi i ligjeve që vinë nga ekzekutivi i vendit. Në këtë Program të Punës së Kuvendit nuk paraparë, e potencuan edhe disa kolegë, agjendat e tjera vetjake të organit më të lartë përfaqësues të Republikës së Kosovës. Nuk janë paraparë seanca të llogaridhënies, nuk janë paraparë me data të caktuara për institucionet që janë të zgjedhura, qoftë si agjencione të pavarura, borde apo edhe mekanizma tjerë dhe kategori kushtetuese që i zgjedh apo emëron Kuvendi. Ato duhet të parashihen me data të sakta, sepse edhe te raportet dhe raportimet, qoftë edhe financiare, po na shtyhen dhe prolongohen raportet e këtyre institucioneve që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për rregullimin e shumë fushave, qoftë institucionale, qoftë të jetës apo edhe të kategorive të caktuara shoqërore në vendin tonë.

Për mua është ende e pakuptueshme, po hyjmë në trevjetorin e shpalljes, që tri vite tani shtet pas 17 shkurtit, pse nuk parashihet Ligji për pronat. Është një projektligj jashtëzakonisht i nevojshëm, sepse ka me qindra e mijëra ngastra kadastrale, sipërfaqe të

tokës, sipërfaqe tani që duhet të shpallen edhe parqe nacionale, që statusi pronësor, titullari i pronës nuk është rregulluar dhe ligjet që do të vijnë pastaj, qoftë nga fusha e mbrojtjes së mjedisit, të bujqësisë apo edhe ligjet tjera, por kjo ngërthen drejtpërdrejt edhe raportet në mes pasurisë publike dhe asaj private, për ligjet të cilat priten të hartohen dhe të marrin bekimin e këtij Kuvendi. Dhe, po më çudit – pse askush nga ekzekutivi i vendit nuk mendon për një ligj kaq të rëndësishëm për vendin, për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-pronësore që janë problematikë, mos të them edhe më herët, por që nga Lufta e Dytë Botërore.

Në kuptimin më pozitiv, nuk do të ketë zbatim të plotë as të Ligjit për partneritetin publiko-privat dhe koncesione, as për shpalljen e disa zonave në Kosovë si parqe nacionale apo zona të një rëndësie të veçantë, kur kemi përbërje mikste ose të përzier të pronës private dhe të asaj publike. Dhe, kush është garantues i pronës dhe i titullarit të pronës. Kjo do të ndikojë pastaj edhe në hartimin e planeve rregullative, të planeve urbanistike dhe të mos flasim për Planin nacional të planifikimit hapësinor. Do të duhej tani, ne si Kuvend i Republikës së Kosovës, thjeshtë të kërkojmë nga ekzekutivi, si organ ekzekutiv, apo pse jo edhe të niset një nismë nga vetë ana e deputetëve. Po i shohim vendet e regjionit, e në veçanti që dy dekada në Shqipëri ende ka probleme të rregullimit të statusit të pronave. Kush do ta nxjerr atë ligj dhe kush do të mendojë për titullarët e pronës tani, si shtet i pavarur. Po ashtu, mungojnë edhe agjenda pune, qoftë nga spektri i diplomacisë parlamentare, pjesëmarrja e mekanizmave dhe përfaqësimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës në institucionet tjera relevante.

Dhe, një vërejtje tjetër konkrete. Të bëhet një prioritet i ligjeve bazike që të hyjnë në agjendën e punës në pjesën e parë të këtij viti, për arsye se kemi ligje shumë të rëndësishme që rregullojnë shumë fusha dhe është caktuar 1 dhjetori i këtij viti, kur e dimë se ai 60-ditshi i procedimit prej leximit të parë deri në leximin e dytë dhe po na ndodhë që i kemi me dhjetëra ligje të bartura nga dy vitet e fundit në vitin 2010.

Unë, në parim do ta përkrah, por këto vërejtje konkrete të deputetëve t'i ketë parasysh edhe Qeveria, po edhe Kryesia e punës së Kuvendit që të harmonizohen dhe të jemi më ekspeditivë në kryerjen e punës tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e merr deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet Gani Koci.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Programi i Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2010, të cilin po e shqyrtojmë sot, është një dokument që ka të bëjë me aktivitetin e planifikuar të Kuvendit të Kosovës, si organ ligjvënës, për vitin 2010.

Që në fillim dua të theksoj se ky program është shumë ambicioz, të cilin mendoj se nuk do jetë lehtë që ta realizojmë duke u nisur nga fakti se gjatë vitit 2009 Kuvendi i Kosovës, nga 127 projektligje të strategjisë legjislativë, ka miratuar 31 ligje, prej të cilave 18 ligje i kanë takuar Strategjisë legjislativë të vitit 2008, ndërsa vetëm 13 ligje të miratuara kanë qenë të Strategjisë legjislativë të vitit 2009. Andaj, këtu edhe lind dyshimi

për realizimin e Programit të Punës për vitin 2010. Ky program i punës përmban 134 projektligje dhe 12 raporte. Këtij numri duhet shtuar edhe 23 projektligje të cilat barten nga vitin 2009.

Nëse dëshirojmë të realizojmë programin e paraparë për këtë vit, duhet që komisionet parlamentare të kërkojnë nga ministritë përkatëse, do të thotë, si propozues të projektligjeve, që projektligjet t'i dërgojnë në afatet e parapara në Kuvend, por edhe Kuvendi, më konkretisht komisionet parlamentare duhet të punojnë me dinamikë më të shpejtuar për të realizuar programin e paraparë dhe jo të ndodhë që projektligjet të barten prej vitit në vit.

Sa i përket dinamikës së shqyrtimit të projektligjeve gjatë vitit 2010, mendoj se nuk është bërë në mënyrë proporcionale sipas muajve. Konkretisht, muaji dhjetor mendoj se është tepër i ngarkuar. Në këtë muaj parashihet që të shqyrtohen 20 projektligje për herë të parë, duhet shtuar edhe dy raporte si dhe disa projektligje në shqyrtim të dytë. Andaj, janë këto gjasa reale që të mos mund të realizohet ky program.

Me gjithë këto vërejtje që i përmenda, por edhe të kolegëve tjerë, megjithatë unë do ta votoj këtë program. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! E ka fjalën deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Do të përpiqem të jem i shkurtër shumë. Ne para veti kemi një program, të cilin program synojmë ta realizojmë deri ë fund të këtij viti dhe ky program është bërë mbi bazën e programeve që i kanë bërë vetë komisionet dhe anëtarët e atyre komisioneve dhe sipas agjendës së tyre është përpiluar dhe është sintetizuar në një dokument që duhet ta miratojë Kuvendi.

Mua po më habit fakti që njerëzit, dëgjova diskutues këtu, thonë që ligje të vjetra dhe ligje të reja. Të gjitha projektligjet që vijnë në Kuvend, janë projektligje të reja dhe ato mund të ndahen në projektligje që zëvendëson një ligj në tërësi, projektligj që ndryshon dhe plotëson një ligj dhe projektligj që rregullon një fushë të caktuar, që nuk ka qenë e rregulluar deri më tash me një ligj. Prandaj, nuk ka projektligje të vjetra dhe projektligje të reja. Ka projektligje që janë të gjitha projektligje të reja. Këtë fakt duhet ta kemi parasysh dhe nuk matet ose suksesi i Kuvendit nuk matet me atë pse ti po bën ndryshime të ligjeve, sepse vetë rrethanat dhe vetë zhvillimet shoqërore dhe të marrëdhënieve të ndryshme kërkojnë edhe rregullim të ri të atyre marrëdhënieve dhe prandaj shtrohet nevoja dhe ndryshimi i tyre.

Problemet që u shtruan këtu rreth mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, edhe kjo, të gjitha komisionet, me sa kam unë njohuri, kanë paraparë mbikëqyrje ose aktivitete të veçanta në mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve dhe, natyrisht, varet se sa do t'i përfillin dhe sa do t'i realizojnë deri në fund. Mu duket i stërzgatur ky diskutim, sepse ky dokument nuk është dokument i mbyllur, por është dokument i hapur dhe që mund të plotësohet në vazhdimësi dhe natyrisht që edhe do të mbetet pa u plotësuar edhe në shumë segmente

dhe në shumë fusha tjera. Ne mund të kërkojmë ligje të reja, por akoma si Kuvend nuk i kemi kapacitetet e nevojshme që ne të fillojmë iniciativën tonë dhe ta realizojmë të drejtën tonë të bërjes së ligjeve, por presim që ato të na vijnë nga Qeveria dhe shpeshherë agjendës, siç u tha, edhe agjenda legjislativë është e përcaktuar nga Qeveria, prandaj po them, t'i shkurtojmë llafet rreth kësaj çështjeje dhe ta miratojmë si të tillë, me mundësinë e plotësimit gjatë punës dhe aktivitetit tonë.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Koci! Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,
Ministra dhe deputetë të nderuar,

Unë do të angazhohem për disa pika të cilat konsideroj se janë me rëndësi të veçantë, qoftë të përcaktuara në plan, qoftë të pa përfshira. Çështja e pronave në Kosovë është çështja më delikate dhe më pak e rregulluar, bile – bile mund të thuhet - krejtësisht e pa rregulluar, me konsekuenca të pa parashikueshme. Ne e dimë fare mirë historikun e pronave në Kosovë, që ka filluar me kolonizime, pastaj ka pasur ekspropriacione, arondacione e të tjera, e të tjera, më pastaj shitje, blerje, të cilat nuk janë regjistruar, Ligji për Kadastrën shumë problematik për tokat e tjera. Shumë pronarë legjitim që janë në Kosovë, nuk janë pronarë legalë. Shumë pronarë, nuk e di shifrën, por sa kam të dhëna, mund të jetë shifër marramendësisht e lartë, që është çështje që nxit për meditim serioz dhe së paku do të duhej të bënim një ligj për pronat, ju lutem. Për këtë mund të flitet shumë, por kjo është e mjaftueshme për këtu. Më pastaj, ne kemi banka, ka depozite, por ato nuk janë të siguruara. Pa sigurimin e depozitimeve bankare, ju lutem, nuk mund të establishohet sa e si duhet sistemi bankar. Pa sistem bankar të establishuar sa e si duhet, nuk ka as sistem ekonomik dhe, rrjedhimisht, as shtetëror. Më pastaj, unë do të isha angazhuar për ta pasur një ligj sistemor për pagat, në cilin do të përcaktoheshin kriteret, bazat dhe masat fundamentale me të cilin do të eliminoheshin shumë diskrepanca të pajustificueshme me asgjë. Po e zëmë, i kemi disa që quhen sot korporata apo ndërmarrje publike që nuk janë korporata, sepse tjetër është korporata e tjetër është ajo që është realitet, që janë pagat, me asgjë të justifikueshme, shumë të larta dhe në anën tjetër, po e zëmë, po e marrim ne mjekun specialist, po e zëmë, që duhet të ketë më së paku 10 vjet pas shkollës së mesme punë intensive, që e ka një pagë trupërisht të ulët e tjera, e tjera.

Do të isha angazhuar që ta bënim një ligj për ekstra profitin. Shtetet moderne e kanë ligjin për ekstra profitin dhe prej aty më pastaj ne do të kishim krijuar edhe fond rezerv shtetëror dhe, fundi i fundit, ne kemi me qindra pika në të cilat do t'i kishim orientuar, do të kishim bërë sanim sado-kudo, deri diku, apo jo.

Do të duhej ta bënim një ligj sistemor për ambientin, jo si Ligji për ujëra. Ai do të ishte ligj i veçantë, ligj sistemor për ambientin, se ambienti nuk ndahet, ujërat nuk ndahen prej ambientit, as pyjet, po e zëmë, nuk ndahen prej ambientit, as tokat ndërtimore, as tokat bujqësore, janë në kompleksitet, prandaj ky ligj neve shumë na nevojitet, sepse ka shkatërrime të pyjeve, ka shkatërrime të tokave bujqësore e tjera, e tjera. Duket që nuk ka kush që i ndalon.

Për vendbanimet, ne kemi nevojë një herë e mirë t'i rregullojmë toponimet, emërtimet e toponimeve, të etnonimeve, të hidronimeve, ju lutem, sepse për një rrugë, po e zëmë, për një kodër, për një shpat, për një fushë e tjera, ka emërtime të llojllojshme edhe arbitrare, edhe zyrtare, edhe jo zyrtare. Shteti ka nevojë për ato të dhëna, të jenë të sakta, ekzakte dhe qytetari ka nevojë të madhe. Do të isha angazhuar ta bëjmë një ligj, ta fusim, ta inkorporojmë diku, t'ia gjejmë vendin. Ligji për universitetin. Ne sot e kemi universitetin publik, ju lutem, është një ligj tepër i dobët dhe ndër të tjera pasojë e ligjit të dobët është që, po e zëmë, shpallet konkursi për 700 – 800 studentë, pranohen 3.000 studentë, përmbi 2.000 pranohen ilegalisht. Kjo është tepër e keqe, punë e keqe është. Më pastaj, kemi universitete, tani quhen kolegje, a nuk ka term kolegji në Ligjin për universitetin. Ka nevojë ta bëjmë një ligj të mirë për universitetin publik dhe privat, ju lutem, dhe të mos kërkojmë më pastaj që të ketë secili qytet, po e zëmë, por të ketë propozicione se kur dhe ku mund të themelohet një universitet. Mos të bëjmë universitete publike për të fituar poenë apo disa grosh politik për zgjedhjet e mundshme të ardhshme, por të bëjmë përnjëmend aty ku duhet, nëse duhet dhe nëse ka nevojë. Ama, ligji do ta rregullonte këtë.

Ligji për parqet ndërkombëtare. Shtetet moderne i kanë ligjet për parqet kombëtare. Do të isha angazhuar për një Ligj për procedurat legjislative. Ne sot, po e zëmë, hiq më larg se në seancën e sotme, kemi pasur projektligj me shumë defekte dhe po ta kishim ligjin, atëherë do të ishim..., ju lutem, nuk janë plotësuar këto kërkesa nga ky ligj dhe do të ishte kthyer ligji, nuk do të ishte ardhur fare, po e zëmë, në Kuvend.

Do të isha angazhuar për ta përgatitur një ligj për mbikëqyrjen e implementimit të akteve ligjore, se ne mund të bëjmë ligje të mira, numerikisht shumë dhe eventualisht me kualitet, me cilësi, por në qoftë se nuk zbatohen, e ne jemi dëshmitarë që, natyrisht, nuk kemi dëshirë të jetë ashtu, po është asisoj, që numër i madh i dispozitave të akteve ligjore aplikative nuk implementohen fare ose disa të tjera implementohen, po me defekte, e këtë deri në një masë të konsiderueshme do ta kishim përmirësuar gjendjen nëpërmjet një akti ligjor. Natyrisht, edhe dispozitat ndëshkimore. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputetja Nurisha Hula.

NURISHA HULA: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Deputetë të nderuar,

Propozim-Programi i Punës së Kuvendit është dokument i rëndësishëm nacional për vitin 2010, është i strukturuar mirë dhe me propozime të projektligjeve të bollshme, me sponsorizues dhe propozues të caktuar, kryesisht nga Qeveria e Kosovës, me afat kohor për procedim dhe miratim në Kuvend. Por, çka është esenciale në këtë Program të Punës së Kuvendit 2010?

1) Sigurisht që duhet të realizohet në afatin e paraparë, e mos të ndodh sikurse në programet e kaluara 2008-2009, ku as për së afërmi nuk është realizuar në nivel të duhur puna sipas Programit të Kuvendit, ku janë bartur projektligjet prej vitit në vit. Do të thotë, prej vitit 2008 në vitin 2009 janë bartur 18 ligje, ndërsa prej vitit 2009 në 2010 do të

barten 23 ligje, kurse në programin e vitit 2010 janë 133 ligje dhe 13 raporte që do të shqyrtohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

2) Për të qenë ligjet e miratuara dhe të zbatuara, nevojitet që Rregullorja e Punës së Qeverisë së Kosovës të përcaktojë afatin kohor se sa kohë duhet të kalojë nga dita e miratimit të projektligjit në Qeveri deri në ditën e dërgimit të tij në Kuvend, prandaj rekomandojmë që të intensifikohet afati kohor në Rregulloren e Qeverisë, i cili afat nuk ekziston.

3) Të mos zgjatet afati kohor sikurse ka ndodhur gjatë vitit 2009. Dërgimi i projektligjeve në Kuvend nga dita e miratimit në Qeveri e deri në ditën kur është për të protokolluar në Kuvend, ka zgjatur 6 ditë gjer në 6 muaj, siç është konkretisht Projektligji për qytetin e kryeqendrës së Republikës së Kosovës, për Prishtinën, i cili nuk figuron në këtë Program të Kuvendit të Kosovës 2010.

4) Strategjia legjislative 2009 tregon indikatorë të qartë se 44.8% janë realizuar, është realizuar programi i strategjisë legjislative dhe vetëm 27% e vendimeve të Qeverisë së Kosovës në 2009 sillen rreth strategjisë legjislative. Konsideroj se kjo nuk do të duhej të ndodhte rreth këtij Programi të Kuvendit të Kosovës 2010, prandaj indikatorët e cekur informojnë se trekëndëshi Qeveri – Kuvend – Ministri – Qeveri ka qenë në proporcion të zhdrejtë në realizimin e Programit të Kuvendit dhe të Strategjisë legjislative të Qeverisë 2009. Në kuadër të kësaj që e ceka, ka pasur edhe veprime ad-hoc me shtimin e ligjeve tjera, përveç atyre që kanë qenë në program, dhe kjo ka çrregulluar shpeshherë edhe punën e komisioneve parlamentare në ligjvënien dhe në mbikëqyrje të ligjeve në Kuvend, prandaj rekomandojmë që edhe kjo të korrigjohet dhe të rregullohet.

5) Miratimi i ligjeve sipas Planit 2010 dhe përafrimi i tyre me standarde të BE-së mund të konsiderohet si fusha më e fortë e të gjitha qeverive, mirëpo edhe më tutje mbetet sfida e zbatimit të tyre që roli kryesor i ligjvënies është edhe i komisioneve parlamentare, që rregullisht të mbikëqyrin zbatimin e ligjeve, sepse vetëm me zbatimin e plotë të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ne mund të tregojmë sukses. Prandaj, në parim, ne e përkrahim Programin e Punës së Kuvendit 2010, me synim që ta realizojmë bile mbi 80%. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Sigurisht që kjo dinamikë e Programit të Punës të Kuvendit duhet të ketë edhe hapësirë të mjaftueshme për monitorim të implementimit apo të zbatimit të ligjeve dhe të akteve tjera që dalin të votuar nga Kuvendi.

Do të mbes me dëshirë që kjo strategji apo ky program i punës të implementohet në tërësi, edhe pse këtu nga projektligjet e propozuara, po të shikohen me vëmendje, disa

edhe krijojnë konfuzitet dhe ndoshta e rrisin atë numrin dhe, sigurisht, prej asaj që kemi lexuar dhe që kemi në proces, disa bien në konfrontim me njëri-tjetrin.

Fjalën e kam për Projektligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, i cili nuk ka të bëjë fare, domethënë, me luftimin e kësaj dukurie apo të aktiviteteve kriminale, më shumë flitet për formimin e njësisë, një njësie të inteligjencës financiare, kompetencat, detyrimet e tjera, e cila po të jetë, po të shikohet mirë, nuk do të kishte nevojë, sepse është Projektligji për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, i cili parashihet që të vijë në fazën tjetër. Këtu, çka shkon edhe më tutje, flitet edhe për kompetencat e gjykatave, i cili bie në kundërshtim edhe me ligjin që do të vijë për gjykatat. Ne kemi në procedurë edhe Ligjin për financimin e subjekteve politike, për shembull, dhe akoma nuk kemi gjetur zgjidhje se cila do të jetë mënyra e financimit, sa, ndërsa në këtë projektligj flitet edhe shuma se sa duhet të financohen partitë politike, cilat shuma do t'i marrin format e raportimit e tjera. Kjo, do me thënë, do të krijojë konfuzitet në zbatueshmërinë e këtyre projektligjeve.

Unë mendoj se kjo dinamikë e punës dhe ardhja e projektligjeve duhet të bëhet sipas rëndësisë së projektligjeve apo asaj që ne e quajmë – paketë e ligjeve. Për shembull, nuk mund të jenë të ndara Projektligji për bankat, për transaksionet e pagesave, Projektligji për raportimet financiare të ndërmarrjeve apo Projektligji për mallrat e liruara nga taksat doganore, duke marrë parasysh se të gjithë kanë lidhshmëri njëri me tjetrin, ndërsa kanë mospërputhshmëri në ardhjen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Këto janë vërejtjet e mia, në parim. Edhe një herë, thashë, mbes me dëshirë. Ajo çka e ceku edhe kolegja jonë, këtu nuk shihet, zoti kryesues, Projektligji për Prishtinën, edhe këtë vit sigurisht që Qeverisë do t'i duhet kohë për ta sjellë nga ndërtesa deri këtu në Parlament apo nga Kryesia deri në seancë plenare. Kjo mbetet të shihet në të ardhmen. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Mua po më drejtoheni – zoti kryesues. Po e kuptoj si referencë e të folurit, që njeriu e do dikë, për ta bërë si dialog. S'je i pari ashtu. Sa për ligjin, LDK-ja që e ka bërë marrëveshjen me PDK-në, le ta bien ligjin këtu. Kjo është shumë e qartë. Ju keni thënë që jeni marrë vesh – bjereni! Fjalën e ka Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Zoti kryesues, faleminderit!

Meqenëse mu ka duktë se e kam lypur fjalën si në fillim, por shumë u përsëritën prej këtyre elementeve, por kisha propozuar që të gjitha këto çka po diskutohen, të inkorporohen, e thatë më herët se është vetëm me një lexim, e mos të flasim në parim. Po propozoj që në radhë të parë – Projektligji për Prishtinën të jetë i pari prioritet, sepse dihet çfarë fushate është bërë në komunën e Prishtinës dhe gjithkund është thirrur në mungesën e ligjit. Duke e trajtuar komunën e Prishtinës si kryeqytet dhe specifikë me statut administrativ të veçantë, propozoj që Projektligji për qytetin, për kryeqytetin e Kosovës – Prishtinën, të jetë i pari që duhet të radhitet në Planin e Punës së Kuvendit.

Ndërkaq, u fol shumë për pronat. Unë kisha thënë që të futet edhe në kuadër të kësaj strategjie, apo programi të punës edhe Ligji mbi dekonfiskimin e pronave, sepse kemi shumë prona që AKP-ja, AKM-ja më herët i kanë privatizuar dhe njerëzit janë të vrarë, pikërisht edhe iu ka konfiskuar pasuria dhe prona e tyre dhe sot luhet me këto familje.

E treta, çka kisha mund të them me këtë rast, është se u përmendën në vazhdimësi, po shihet se është Kuvendi inferior ndaj Qeverisë, kjo vazhdimisht po shihet, nuk kemi pasur nevojë të përshkruhen projektligjet e hequra nga rendi i ditës në seanca plenare me kërkesë të Qeverisë, sepse Kuvendi ka vendosur për këtë dhe nuk është dhënë asnjë afat për Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës, do të thotë Qeveria e Kosovës funksionon pa ligj, funksionon me një rregullore të kryeadministratorit të Kosovës apo të OKB-së – Rregulloren e UNMIK-ut dhe shumë ligje tjera që janë rregullore të UNMIK-ut që janë futur edhe vazhdimisht askush nuk ka mund të bëjë një ndryshim, është fjala për Ligjin mbi shërbimin civil, në këtë rast, qysh po shkruan këtu, është Rregullorja 2001/36 - Ligji i punës, Rregullorja 2001/27 dhe shumë tjera që janë ligje bazike dhe i duhen Kosovës, në këtë rast edhe institucioneve të saj, po kryesisht ato të vendosen dhe të jenë në prioritet, po kisha kërkuar që në radhë të parë Projektligji për Prishtinën dhe të spastrohet njëherë e përgjithmonë gjendja për Prishtinën dhe kryeqytetin, ai është prioritet që propozoj në këtë rast. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Demaliaj! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm, shumë gjëra u thanë këtu. Unë desha edhe një herë ta potencoj më fuqishëm nevojën për Ligjin për privatizimin. Ligjin për privatizimin e sektorit të energjisë elektrike dhe privatizimin e PTK-së, duke marrë parasysh se Qeveria këto dy asete kryesore të Kosovës i ka dhënë prioritet për këtë vit. Mendoj se është fundi që privatizimet e rëndësishme të bëhen me anë të këshilldhënies të këshilltarëve, të transaksioneve, me këshilla të ekspertëve, të miqve ekspertë ndërkombëtarë, mendoj se është fundi i privatizimit të aseteve kryesore të Kosovës nëpërmjet opinionëve të opinionistëve, që herë na japin opinione, mendime, këshillime si ta përmirësojmë shëndetësinë, po të njëjtit edhe si ta privatizojmë KEK-un apo minierat e Kosovës apo postën.

Kam parasysh edhe kur flas për këta këshilltarë, që marrin para goxha për këshillime, se shpesh na vijnë edhe disa matrapazë, siç ishte rasti me skandalin e sivjetmë, të vjetëm, në realitet, të gushtit, kur iu dha tenderi Konzorciumit SMC Lavnin, konzorcium i cili iu dha për një shumë të caktuar, një shumë të majme të parave për të dhënë këshillime se si të privatizohet PTK-ja, e që në realitet SMC Lavnin është e akuzuar për korrupsion dhe akuzohet për përfshirje në korrupsion të zyrtarëve në Indi, gjithmonë flas sipas gjetjeve të Auditorit të Përgjithshëm të Indisë, më 22 janar të vitit 2009, e në gusht të vitit 2009, ata vinë e na japin këshillime se si ta privatizojmë PTK-në.

Po ashtu edhe ASP Konsolting është një ndërmarrje e këshilldhënies, e cila akuzohet apo dyshohet për korrupsion. E njëjta gjë, po them, vlen edhe për KEK-un. Nuk mundemi ne sot t'ia japim një vlerësim sipas, gjithmonë flas, miqve, ekspertëve ndërkombëtarë, një projekt, të nesërmit ta ndërrojmë atë projekt, pasnesërmit ta ndërrojmë atë projekt, apo siç ishte rasti me atë çmimin qesharak që iu dha PTK-së dhe më pastaj të kërkohet nga të njëjtit persona transparencë, të kërkohet respektim të përvojave të avancuara e tjera, e

tjera, por po them, askund nuk përmenden ligjet, ashtu siç kanë, po them, këto përvoja të avancuara kanë bërë gjithkund.

Unë e pash këtë agjendë. Nuk them se Ligji për “Gazetën zyrtare” nuk është me rëndësi, është me rëndësi, është prioritet i kësaj qeverie. Po ashtu, Ligji për Muzeun, edhe ai është projekt prioritar për Qeverinë, por mendoj se prioritet duhet të jetë edhe Ligji për privatizimin e PTK-së dhe Ligji për privatizimin e sektorit të energjisë, të cilin jemi kah e kërkojmë që sa e sa, një grup i qytetarëve të Kosovës, përfshirë këtu edhe Shoqërinë Civile, andaj do të propozoj dhe do të kërkoj që këto dy ligje me rëndësi të posaçme të futen në agjendë për sivjet. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

JAKUP KRASNIQI: Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet Bahri Hyseni. Deputetit Berim Ramosaj me kartelë të Ali Lajçit.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë e shfrytëzoj rastin t’ju përshëndes, kolegë deputetë dhe ministra, që jeni prezent!

Vërtet, unë atë çka desha ta theksoj në veçanti, është fjala për korpusin e ligjeve që rregullojnë çështje të natyrës ekonomike.

Në këtë Program të Kuvendit për këtë periudhë, që po na pret në fakt, nuk shihet apo nuk reflektojnë një mori ligjesh me të cilat i mundësojmë ekonomisë kosovare që të jetë atraktive në raport me vendet tjera.

Duke marrë parasysh se vendet e regjionit, respektivisht të Evropës Juglindore janë në proces të aprovimit të shumë ligjeve që ekonominë e tërë e bëjnë shumë atraktive edhe në kuptimin e investimeve nga jashtë, edhe në kuptimin e investimeve të brendshme, ky korpus i ligjeve ekonomike që janë propozuar këtu nga Qeveria e Kosovës, për legjislativin e vendit, nuk na jap të kuptojmë se do të krijojmë një mjedis të përshtatshëm për zhvillim ekonomik në Kosovë. Kur them – një mjedis të përshtatshëm, mendoj që duhet të gjejnë shprehje Ligji për korporatat, Ligji për tatimin në fitim të kompanive, qoftë vendore, qoftë të huaja, Ligji për investime direkte dhe ligjet tjera të cilat kishin për ta sjellë Kosovën në një pozitë më të mirë se është sot në kuptim të thithjes së investimeve nga jashtë.

Kjo ishte sa i përket korpusit të ligjeve të natyrës ekonomike. Kisha edhe një herë për të ritheksuar, sikur shumë kolegë të mi që e thanë, se mungon Ligji për kryeqytetin, gjë që ka qenë një kërkesë vërtet shumë e theksuar në periudhën para zgjedhore dhe në periudha të mëhershme që të rregullohet një herë ky fenomen. Nuk ka vend në botë që nuk e ka të specifikuar pozitën e kryeqytetit të vendit. Andaj, vërtet, në qoftë se dëshirojmë që qyteti i Prishtinës, respektivisht kryeqyteti i Republikës së Kosovës të ketë një pozicion të caktuar, duhet të rregullohet me ligj.

Unë nuk po e shoh as në program se do të kemi as ndryshimet, as lexim të veçantë apo kthim prapa, andaj kisha apeluar edhe një herë në ata që bëjnë projeksione për programin për këtë vit, që të gjejnë një variant të futjes në rend dite edhe të Ligjit për kryeqytetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe për ju! Megjithatë, unë po ua tërheq vetëm vëmendjen, se ky program i punës ka kaluar nëpër komisione të Kuvendit të Kosovës dhe ka ardhur sot këtu. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht që do të ishte shumë ideale ajo që Kuvendi i Kosovës t'i aprovojë 135 ligje dhe po shohim vullnet që ka edhe propozime të reja, por nuk po shohim asnjë vullnet që asnjë komision parlamentar nuk ka marrë të jetë sponzorizues i asnjë ligji në Kuvendin e Kosovës.

Unë po kërkoj që të plotësohet programi i punës, e konsideroj të mangët. Administrata ka qenë dashur që në pikën 61, ku ka përmendur raportet vjetore të agjencive të pavarura për vitin 2009, e ka lënë me një pikë krejt, që do të raportojnë prej marsit në shtator dhe nuk e ka shkruar, cilat agjenci do të raportojnë, kohën kur do të raportojnë, cili nga komisionet parlamentare është komision funksional? Prandaj, konsideroj se ky është një dokument publik dhe kjo duhet të plotësohet gjithsesi prej administratës, edhe ne ta kemi më të qartë, por edhe agjencionet, sepse ka pasur raste që dy raporte ju kanë dërguar komisioneve dhe kemi hasur në dilemë se cili nga komisionet është komision funksional – raportues.

Dhe, një çështje tjetër, konsideroj që këtij raportit të punës apo të këtij programit të punës është mirë t'i shtohet që secili nga komisionet parlamentare, së paku ta ketë monitoruar një apo dy ligje. Edhe kjo duhet të jetë në planin e punës. Nga kjo që po shohim, edhe pse disa komisione e kanë në agjendë monitorimin e ndonjërit nga ligjet që i kemi aprovuar, këtu nuk kemi parë në raport asnjë nga ligjet që do të monitorohen. Unë konsideroj që duhet të jetë, sepse është shumë e rëndësishme, nuk është, domethënë, aspekti i parë vetëm nxjerrja e ligjeve, por edhe monitorimi i ligjeve është një nga detyrat që e kemi marr edhe obligim, si komisione, prandaj sugjeroj që raporti të plotësohet. Nëse komisionet nuk kanë marrë për obligim të monitorojnë asnjë ligj, së paku unë nuk po e shoh komisionin tonë që ka marrë për obligim, që e ka shkruar administrata, por të marrin për obligim që, së paku, çdo komision në fund të mandatit të monitorojë së paku një ligj, sepse do ta kishim atëherë pa efekt këtë punë që e kemi bërë. Dhe, një sqarim, Ligji për deputetët është në agjendë, por nuk e kanë shkruar në agjendën legjislative të vitit 2010, që është e kuptueshme, ky është ligj në përfundim dhe nuk është i agjendës 2010. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet Berat Luzha.

KAQUSHA JASHARI: I nderuar kryetar dhe kolegë,
Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor është propozuar sivjet në muajin e dhjetë. Në muajin e dhjetë janë propozuar edhe shumë ligje tjera. Unë e di se është punuar shumë për këtë projektligj, është i gatshëm për diskutim, por në një mënyrë është ikja për ta hapur këtë diskutim.

Unë vetëm po jua përkujtoj se është bërë edhe një mocion në janar 2009 për këtë projektligj, përgjigjen prej Qeverisë nuk e kemi marrë, e ka qenë obligim për tre muaj dhe në pyetjen time Qeverisë, zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi, ka premtuar që në fund të vitit 2009 do të procedohet, që nuk ka ndodhur. Prandaj, e kam një propozim konkret, zoti kryetar, që votohet që këtë ligj ta bëjmë deri në qershor sivjet, se ligji është punuar dhe shumë është punuar në te. I kemi dy ligje të propozuara deri në qershor, është Ligji për sigurimin shëndetësor, gjithashtu edhe Ligji për punë, prandaj edhe ky ligj i treti kishte qenë në një mënyrë një pako shumë e nevojshme për diskutim dhe ta rregullojmë këtë çështje. Propozim që të votohet për ligj, që ofrohet, se ligji është i gatshëm.

Diçka tjetër desha. Në qoftë se është Qeveria efikase dhe na i procedon ligjet, me siguri Kuvendi do të ketë punë edhe në mënyrë më dinamike, por nuk shkruan kurrkund këtu në program edhe për problemet ose obligimin që e kemi në këtu për ta zbatuar ligjin. Shpesh edhe komisionet funksionale nuk janë efikase për shkak të mos ngutjes se deputetëve, po i lënë grupet punuese më vonë, nuk tubohen, prandaj realizimi i këtij programi varet edhe prej angazhimit dhe përgjegjësisë tonë. Gjithashtu, edhe një, nuk po them pyetje, por edhe një mënyrë pune të Kuvendit nga Kryesia. Mocionet të cilat të cilat ia dorëzojmë në Qeverisë, presim vetëm përgjigjen prej Qeverisë. Ku është roli i Kuvendit për të kërkuar respektimin e Rregullores? Pse pyetja në mocionin e dërguar, e nënshkruar nga deputetët, nuk ka përgjigje? Mendoj se kjo është çështje e Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Berat Luzha dhe i parafundit Hydajet Hyseni Kaloshi, pastaj Naim Rustemi.

BERAT LUZHA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam i shqetësuar për fatin e Projektligjit për të burgosurit, për të drejtat e të burgosurve politikë. Ka dy vjet që ky ligj është bërë gati nga një grup deputetësh, është nënshkruar nga 65 deputetë dhe ende nuk paraqitet për miratim. Këtu shkruan se është në pritje të deklaratës financiare nga MEF-i Vërtet, edhe sa vjet duhet të pritët që MEF-i ta sjellë deklaratën financiare për këtë projektligj dhe MEF-i duhet të na tregojë, kanë të drejtë që të burgosurit politikë të kenë projektligj ose, nëse nuk kanë të drejtë, atëherë të tregojë se nuk kanë të drejtë.

Ky projektligj vërtet është më se i domosdoshëm dhe duhet të futet në shqyrtim menjëherë në procedurë parlamentare. Është i vetmi projektligj që këtu nuk figuron afati i shqyrtimit, as në shqyrtimin e parë, as në të dytin, prandaj është lënë në mjegull dhe jam i bindur që kështu do të mbetet në këtë vit dhe do të shtyhet në pambarim.

Unë mendoj se edhe Projektligji për pyjet duhet të përshpejtohet, është paraparë që të jetë në dhjetor të këtij viti, por shqyrtimi i parë në dhjetor dhe pastaj shqyrtimi i dytë do të zgjatë sigurisht dhe do të jetë në vitin 2011, prandaj është shumë e domosdoshme që ky projektligj të bëhet sa më shpejt që është e mundur, për shkak se as plotësimit ndryshimi i Projektligjit për pyjet që u bë sot, nuk i plotëson të gjitha kriteret ligjore për bartjen e kompetencave në komuna, siç parashihet me Pakon e Ahtisarit.

Kemi edhe Rregulloren e Punës, e cila është e gatshme që një vit dhe nuk del në Kuvend, për miratim, mendoj që duhet të procedohet dhe të miratohet menjëherë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Berat, aty Hydajetin e ke shumë afër, e di që nuk është bash krejt gati, por mbasi Hydajeti e ka fjalën, të tregon.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Ju përshëndes ju dhe e përshëndes këtë debat, ndonëse ç' është e vërteta, në fillim me dukej sikur, vërtet, po bëjmë një debat që të del pak jashtë natyrës së pikës së rendit të ditës. Megjithatë, fakti që nuk është bërë puna siç duhet, sa e si duhet nëpër komisione, mendoj që po e justifikon edhe këtë mënyrë të angazhimit të deputetëve.

Ç' është e vërteta, në Rregulloren e Punës është thënë, në Rregullën 22: "Kuvendi i zhvillon punimet sipas kalendarit të propozuar nga Kryesia në konsultim me Qeverinë, me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe të komisioneve parlamentare, të miratuara nga Kuvendi". Këtu është punë Kuvendi, si të thuash, ku duhet të ndërtohet programi i punës, por janë edhe një sërë çështjesh që mbeten jashtë këtyre trupave. Prandaj, mendoj që është mirë që është krijuar kjo hapësirë, por besoj që e ndaj edhe mendimin tuaj se ka një ngatërrim në përdorimin e nocioneve: program i Kuvendit, kalendar i Kuvendit dhe diku- diku pastaj strategjia ligjvënëse.

Po të shikojmë programin e punës, në të vërtetë do të shohim se është një agjendë ligjvënëse dhe jo edhe programi gjithëpërfshirës i Kuvendit. Mendoj që kjo mund të plotësohet në të ardhmen.

Mua më bën përshtypje edhe një insistim vazhdimisht në faktin se Qeveria po propozon ligje dhe sikur në këtë mënyrë Qeveria po tejkalon kompetencat e saj dhe po i imponon Kuvendit agjendën e punës së tij. Unë e kam theksuar edhe në ndonjë rast tjetër, në bazë të asaj që kam lexuar edhe në literaturën parlamentare, kjo nuk është vërejtje që i bëhet Qeverisë, po objektivisht është kompliment. Qeveria që arrin t'i imponojë Kuvendit agjendën ligjvënëse dhe ta mbushë atë me propozime dhe me forma tjera, me raportime e tjera, pikërisht është në nivelin e misionit të saj. Unë druaj që Qeverisë sonë, ky kompliment mund të jetë i tepruar, sepse ka vend edhe për t'i bërë vërejtje, por nuk mund t'i bëhet vërejtjeje pse ajo sjell ligje dhe në këtë mënyrë edhe e bën agjendën. Kështu edhe duhet të bëhet, sepse Qeverinë e kemi formuar pikërisht për të realizuar programin e saj, pjesë e së cilës është edhe agjenda ligjvënëse.

Vërejte eventuale Qeverisë mund t'i bëhet për mosharmonizimin gjithmonë të duhur midis agjendës ligjvënëse dhe planit të afatmesëm të shpenzimeve dhe ndonjëherë ndodh këtu pastaj ngatërrimi. Një ligj që është futur diku në agjendë ligjvënëse, nuk është shoqëruar pastaj edhe me përgatitjet e mbulesës financiare, ose ka qenë një projektligj edhe kjo që e përmendi parafolësi, qysh në disa vjet e disa mandate, madje qeveritare përpara, por Qeveria nuk ka bërë asgjë që ta përgatisë draftin dhe aq më pak, pastaj, të përgatisë edhe parakushtet për realizimin e këtij projekti.

Për pasojë, krijohet pastaj fenomeni i tretë. Edhe kur nis nisma nga deputetët ose nga komisionet, kërkohet prej Qeverisë përgjigja, jo gjithmonë me arsye, siç ishte në fjalën – Ligjin për të burgosurit politikë, sepse nuk kishte kosto financiare, por Qeveria thjeshtë e injoron dhe është bërë njëfarë, si të thuash, shprehie që kjo të konsiderohet sikur Qeveria e konteston. Në praktikën parlamentare të vendeve demokratike, Qeveria që në afatin e caktuar nuk përgjigjet, nuk jep mesazhin se ajo nuk pajtohet me ligjin, heshtja është miratim dhe nuk është kontestim dhe mbi këtë bazë nuk bën të bllokohen nismat e deputetëve. Qeveria duhet të japë përgjigje në afatin e caktuar, përndryshe interpretimi është se ajo nuk ja vërejtje në të.

Unë do të dëshiroja të tërheq vërejtjen tuaj sidomos në një fushë, mendoj, e cila te ne nuk është mbuluar, ku bën pjesë edhe çështja e Ligjit, vërtet tej mase të zvarritur, për të drejtat e ish të burgosurve politikë, ajo që quhet drejtësia tranzicionale. Kosova është i vetmi vend që nuk ka bërë asgjë në këtë fushë dhe Kosova ka më shumë arsye se sa të gjitha vendet tjera për të lëvizur drejt atyre standardeve që janë rekomanduar dhe masave që janë rekomanduar edhe nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. Kosova duhet të marrë masat edhe për të reformuar sistemin e drejtësisë, të gjyqësisë, që është segmenti më i pa reformuar në Kosovë dhe në këtë bazë edhe të sigurojë, t'i ofrojë, Qeveria Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë kosovare Ligjin, e vonuar, të stërvonuar, për lustracione, për lustrimin. E kanë vendet tjera, duhet ta ketë edhe Kosova dhe pa këtë ligj, zor të kemi atë cilësi që po e kërkojnë në këtë segment shume të rëndësishëm të shoqërisë sonë.

Duhet të krijohen kushtet, më në fund, edhe për një trajtim, si të thuash, të merituar edhe të viktimave të sistemit të padrejtë të së kaluarës. Për mendimin tim, është edhe një defekt i madh në ligjvënien tonë. Pakoja e ligjeve të ashtuquajtura, pakoja e ligjeve të Ahtisarit. Ju, zonja e zotërinj, e dini se si janë miratuar ato ligje, pa një procedurë të rregullt demokratike, pa transparencën e duhur dhe me shumë defekte. Nuk kërkoj që të bëhet ajo që është bërë të ribëhet, mund të ribëhet, por nuk ka asnjë pengesë që ne t'i hyjmë, më në fund, procesit të korrigjimit të defekteve evidente dhe me pasoja po ashtu evidente, për të cilat mendoj që, megjithatë, ka mundësi që të korrigjohen, natyrisht duke respektuar procedurat dhe ligjet që janë miratuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Naim Rustemi dhe i fundit prej deputetëve të paralajmëruar, ndoshta lajmërohet edhe ndonjë i ri.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

Unë do të jem shumë i shkurtër, sepse u ngritën disa prej çështjeve, u ngritën edhe prej dy apo tre deputetëve, që e ngritën një çështje që ka rëndësi të veçantë në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Dhe, u dhanë disa propozime që të formohet një Ligj për privatizimin e ndërmarrjeve publike, posaçërisht me theks të veçantë të PTK-së dhe të KEK-ut, kështu që unë e shoh të arsyeshme, në rast se ndodh që të mos futemi në krijimin e një ligji për privatizim, që së paku ta fusim në agjendë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve për ndërmarrje publike, sepse mendoj se aty ku sqarohen kompetencat e Qeverisë dhe të Kuvendit lidhur me iniciativat për privatizimin apo shitjen e aseteve të ndërmarrjeve publike, kemi mangësi të mëdha. Poçërisht, në pikën e fundit të nenit 4, që nuk po hyjë krejt për ta analizuar, bëhet një relacion me Ligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve, që nuk është diçka e cila kishte për të na mundësuar që në mënyrë të drejtë, transparente, me metoda të hapura dhe konkurrencte t'i privatizojmë asetet më të vlefshme të Kosovës. Kështu që kisha pasur dëshirë ta shoh në agjendën e Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2010, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, me theks të veçantë në nenet që kanë të bëjnë me privatizimin e aseteve të ndërmarrjeve publike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti dhe po shpresojmë që po e përmbyll Sabriu debatin.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Kolegë të nderuar dhe ministrat më të durueshëm të LDK-së, edhe ky i turqve, bravo!

Kolegë të dashur,

Ne biseduam sot për një tekst, në të vërtetë, në mënyra pak të ndryshme. Unë, meqë isha atje duke udhëhequr, nuk doja të moderoj, sepse ju e dini që ai duhet, sa të mund të jetë neutral, sa ta ketë fjalën atje. Po ju them që mënyra qysh është biseduar sot për këtë projekt, është pak e çuditshme, sepse edhe deputetët janë bërë demagogë të mëdhenj, tepër është bërë puna, po më duket, tash, sepse bëjnë kritika ndaj atyre që hartojnë ligje e vetë s' hartojnë, e kanë, 6 deputetë të Kuvendit mund të hartojnë ligj. Njeri i gjallë nuk i pengon. Natyrisht që do punë ajo, se legjislacioni është shkencë, nuk është retorikë. E kemi njërin që zakonisht mban ligjërata të tilla, profesorin këtu që edhe sot nja 10 minuta ka mbajtur ligjërata edhe prej lart s'desha t'i them, por tash po i them, meqë shoh që ka afinitete, teoritikisht flet shumë për këto probleme, le të hyjë në Komisionin e Legjislacionit, unë nuk di a është atje, dhe le t'i ndalë ligjet pa mbërri në lexim të parë. Krejt këto kanë të bëjnë me temën e sotme. Të drejtën legjislative, 6 deputetë të Kuvendit kanë të drejtë të hartojnë ligj, prej astronomie deri në ligjin për thnegla, kush s' i ndal. Ndërsa, nëse flitet për ligjet e Qeverisë, vërejtje në princip s'kanë të drejtë të bëjnë të natyrës së orarit përfaqësuesit e dy partive që janë në koalicion, dy të mëdhave, sepse ata e kanë Qeverinë e vet dhe ata ndikojnë te Qeveria vetë që të krijojnë dinamikën e legjislacionit, s' kanë pse iu drejtohen të tjerëve. Kjo është logjika e prodhimit të ligjeve, të politikave të caktuara qeveritare, tjetër janë punët e shtet ndërtimit, që iu themi ne, ligje të mëdha sistimore, kurrkush nuk ka bërë problem këtu. Domethënë, kemi pasur një konsensus total, por ligjet, politikat e veçanta

qeveritare i prodhon mazhuranca kudo dhe s' ka nevojë të ankohet këtu ose të hidhërohet në dikë s'e nuk është dinamika e mirë.

Unë po flas, dy partitë që janë, njëra është edhe partia të cilës i përkas vet, por një logjikë duhet ta ndjekim. Tjetra, u bisedua, ky është një program i një viti. Rolin legjislativ që e ka Kuvendi i Kosovës, rolin me Kushtetutë, nuk e humb me një program veprimi i cili është 90% program legjislativ dhe do të jetë me detyra legjislative, edhe përfaqësuese, edhe mbikëqyrëse të ekzekutivit, se këto detyra i ka me Kushtetutë dhe me Rregullore dhe nuk mund t'i parashkruhen ose brendashkruhen me një program veprimi që është, po them, 90% legjislativ. Ky program që e kemi në dorë, është 90% legjislativ. Është punë tjetër, nëse analizohet, e duhet të analizohet, cilat janë ligjet në regjistër, që mua me vjen keq, po shumë edhe kolegët që i respektoj shumë, i kanë numëruar ligjet që janë brenda, s' i kanë parë që janë, se nëse i shohin, s' i propozojnë. Ka njeri që ka bërë listë me 7-8 ligje që i ka lypur, që i ka në regjistër, por s' i ka lexuar ose, emrat s' po i them, kush, po dihet.

Në kuptimin e politikave të zhvilluara të kësaj Qeverie dhe të tërë Kosovës për zhvillimin, unë do të nënvizoj që është i domosdoshëm Ligji për Prishtinën, Ligji për Qeverinë e Kosovës, Ligji për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të tria janë ligje të cilat ju ndoshta s' i keni parë, por i rekomandohet me punën e Kuvendit rreth integriteteve që duhet të vijë, tjetra pikë më duket është e rendit të ditës. Të këqyrim, të harmonizojmë çka po bëjmë, a po japim deklaratë koti për integritet, e në të vërtetë nuk i kemi ligjet obligative t' i kalojmë, se kjo lidhet edhe me një dinamikë që më duket, zoti Buja e përmendi, nëse duam në kuptimin legjislativ, e kjo na përket ne, t' iu ofrohemi kërkesave të vlerësimeve që do t' i marrim, duhet të kemi kujdes ligjet që janë kërkuar në vlerësimin e vitit të kaluar, bile këto t' i kalojmë. Këto të dyja janë, që janë kërkuar e s' janë kryer dhe duhet të hynë këtu.

Tutje, Ligji për punën, Ligji për pensionet, zonja Jashari e përmendi, mirë bëri që e përmendi. Në parazgjedhore partitë kanë bërë garë të fuqishme për Ligjin për pensionet. Unë po ju them edhe ky ligj i garave dhe kjo që ju e kërkon me plot të drejtë, për pa ndërtuar fondacion të pensioneve s' ka për t' u realizuar. Prandaj, nëse shtrohet problemi për këtë kategori, që është shumë me rëndësi dhe të kodifikohet me ligj, duhet njëkohësisht të formohet fondacioni, sepse gjithmonë do të ndalem atje ku ju zonjë thatë, vonohet, nuk qitet koha, sepse llogaritet që nuk implementohet, nuk zbatohet. Atëherë, të luftohet të ndërtohen ligjet që do të zbatohen dhe të krijohen parakushtet. Pra, Ligji i punës, Ligji i pensioneve, Ligji i privatizimit, dy deputetët e pavarur e thanë, ato që janë të domosdoshme. Natyrisht, me një ... nuk do të mbyllet legjislatura krejt, po edhe një herë po them, për dinamikën, përgjigjet Qeveria. Qeveria nuk është fajtorë nëse i sponzoron ligjet edhe 120%, Kuvendi e ka mundësinë të hartojë ligje të mira në të gjitha fushat që i intereson dhe, po mendoj, nuk ka arsye që njëri- tjetrit t' i themi, jo ti po punon shumë, unë pak, e ti shumë e keq, e unë pak e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ne e lajmëruam se deputeti Sabri Hamiti është i fundit, tash kemi edhe katër. Po vazhdojmë. Mirë, 2 minuta i ke. E ka fjalën deputeti Riza Smaka, replikë.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra, deputetë,

Për ta bërë një akt ligjor, duhet ta dijë, kush nuk e di, a kush e di, kërkoj ndjesë që e përsëris, se është një punë tepër serioze, jashtëzakonisht e vështirë, e ndërlikuar, apo jo, dhe kërkon infrastrukturë tepër serioze, të cilën mund ta kenë vetëm anëtarët e Kryesisë, që kanë kabinete, kanë xhipa, e kanë sekretarë, e kanë pagesa ekstra e tjera, e tjera. Ndërsa, deputeti, nuk e ka asnjërin prej këtyre, s'them që duhet t'i ketë, por s'ka kushte elementare për punë. Qeveria është institucioni i thirrur që ka punën parësore përgatitjen e akteve ligjore edhe ka të gjitha kushtet e mira e të nevojshme për ta bërë këtë punë, e ka për detyrë, nuk është detyrë e deputetit për të bërë projektligje, se mund ta bënte, po nuk është detyrë themelore, ajo mund të jetë, domethënë, mund të ishte në atë vargun e punëve të tij.

Pra, më pastaj, unë apeloj një herë e përgjithmonë që të jemi prudit e mos të përdorim fjalë të rënda, deputetit apo deputetëve t'u adresohet se janë bërë deputetët demagogë, është fjalë e rëndë, që pa dyshim, automatikisht do të kërkonte sanksionim. Unë s'po kërkoj sanksionim, po së paku tërheqje të kësaj shprehjeje ,apo jo, e tjera, e tjera, e tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Kolegut mund t'i them që demagog në rrënjë, domethënë, mësues, ka marrë edhe kuptim pezhorativ se mësuesi nganjëherë thotë - bëni qysh bëj unë, qysh ju mësoj, mos bëni si unë, kështu që në rrënjë, demagogus, domethënë, mësues, po ne jse. Unë edhe në kuptimin e dytë mendoj që në plot diskutime, qoftë edhe sot, jemi bërë demagogë, tash po them jemi për t'u çliruar ai që mendon që identifikohet.

E dyta, unë tash po ju them me emër, zoti Smaka. Unë në diskutimin tim të kam bërë kompliment. Ti nuk e ke kuptuar, unë vetëm e tërheq komplimentin dhe të garantoj që nuk kam për të përmendur. Unë të kam bërë kompliment, ti s'e ke lexuar si të tillë, atëherë unë e tërheq komplimentin. Faleminderit! Sa i përket punës, a hartohen me vetura, a me dije, përkundrazi unë thashë shumë saktë, unë flas në mënyrë të përmbledhur, hartimi i ligjeve, shkencë thashë, jo retorikë, edhe një herë e përsërita dhe kështu mendoj dhe jam i bindur. Dhe, e dyta është, prapë po kthehem te demagogjia, nëse në këtë sallë u bënë kritika të mëdha që Kuvendin po e sundon Qeveria, se po harton ligje, tani kemi brenda Parlamentit idenë tjetër, jo, duhet veç Qeveria t'i bëjë ligjet. Faleminderit, unë s'flas më për këtë.

KRYETARI: Faleminderit!

Kundër replikë, Riza Smaka, një minutë.

RIZA SMAKA: Zoti kryetar,

Unë e konsideroj respekt për t'i sqaruar gjërat, jo për të bërë kontroversa, si të them, e tjera. Është e padiskutueshme se edhe sikundër të ishte demagog termi mësues, në jetën praktike pothuaj se, sidomos në kontestin e mëparshëm e kishte sensin pezhorativ, aty

është fjala se, tek e fundit, mund t'i thuash edhe akademik me një ironi e me një sarkazëm apo profesor, apo mësues, mirëpo unë gjithmonë kam qenë, jam dhe do të jem tepër i matur, apo jo, sepse në atë mënyrë edhe vetveten e ruaj, edhe tjetrin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Jo replikë lidhur me atë shprehjen që ia vlen të diskutohet, se s'kam mbajtur derës, as s'e kam ndërmend të mbajë derës, por lidhur me tezën që unë e theksova, pak a shumë, ose e kontestova të disa kolegëve deputetë – pse Qeveria po e bën agjendën e Kuvendit, por dua ta sqaroj – jam nga deputetët që kemi bërë jo një ligj, po më shumë se një ligj. Dhe, meqë u përmend që 6 deputetë mund të bëjnë ligj, ne e kemi nënshkruar, zonja dhe zotërinj, 66 deputetë dhe ende ligji qëndron i ngrirë. Por, do të thotë, nuk mendoj se vetëm Qeveria duhet të bëjë ligje. Por, atë që e thashë, nëse s'e kam sqaruar sa duhet, dua ta sqaroj. Qeveria në sistemin tonë ka edhe kompetencën, ka edhe aparatën, ka edhe mbështetjen financiare për të bërë ligje. Ka shembuj nëpër parlamente të botës, për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku deputetët bëjnë ligje, por në ato raste duhet të rriten kapacitetet me ekspertë dhe çdo komision duhet të ketë ekspertë që i ndihmojnë. Zotërinj, ne nuk i kemi këto mundësi. Prandaj, është normale që kryesisht Qeveria të na sjell ligjet dhe ne i bëjmë politikat dhe pastaj i miratojmë ligjet, i ndryshojmë, mund t'i ndryshojmë edhe prioritetet dhe kjo është ajo që është thënë cekem balance midis pushteteve. Uroj vetëm që të na funksionojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naim Rustemi, replikë. Ardian, a do replikë ti?

NAIM RRUSTEMI: Replika ime është shumë e shkurtër. Me qenë se është përmendur fjala demagog, unë nuk e di ku ka në botë më demagogji se Presidenti ta ngrijë funksionin e vet në parti. Kjo është demagogji e llojit të vet. Për të gjitha tjerat po, se s'ekziston pozicion i ngrirë në partinë politike, kështu që diskutuesi që e tha fjalën për deputetë, demagogji është atje, në burim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po nuk ishte kjo temë për këtë çështje...

(Sabri Hamiti, ndërhyrje, nuk dëgjohet mirë për transkriptim)

KRYETARI: Faleminderit! Konsideroj që debati është mbyllur. Ardian Gjini, çka u bë, Ardian? Urdhëro! Deputetit Ardian Gjini, fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

E kam kërkuar fjalën, realisht kenë pasur të drejtë ta mbyllni debatin, por pasi të mbyllen numrat këtu, se po i shohim, të themi – ky është i fundit dhe s'ka më debat.

Mirëpo, faleminderit për fjalën, dua të jem shumë i shkurtër. Në fakt, nuk kam pasur shumë për të thënë, por jam intriguar me disa çështje të cilat në Kuvend të Kosovës duhet të jenë premisa që dihen, nuk po i përmend, i përmend dikush më përpara se cilat janë procedurat. Ne konsiderojmë që duhet për t' i ditur procedurat deputetët, cilat janë

premissa që po i shoh unë këtu, po flas se intriguar edhe një herë po them jo për të bërë diçka më tepër, është se kemi për ta votuar ose për të mos e votuar një propozim sot. Propozimet që jepen këtu në Kuvend për të ndryshuar diçka, janë të kotë, se ose votohet ose nuk votohet, ka pasur proces nëpër komisione edhe po duket që njerëzit kanë harruar të punojnë nëpër komisione për këtë dokument e tash kanë ardhur në seancë plenare dhe donë për t' i plotësuar në seancë plenare, kjo është prapë çuditshëm. Edhe fundi i fundit, po më duket mua që duhet dikush për t' iu bërë seminar, deputetëve të partive në pushtet, se pse bëhen ligjet edhe kush i bënë ligjet? Ligjet nuk bëhen në listë sa për t' bërë që të vijnë këtu dhe ne të lodhemi duke bërë ligje pa lidhje, po ligjet bëhen se dikujt i ka shkuar mendja për ta rregulluar një sferë të caktuar edhe i dinë procedurat se kush mund t' i bëjë ato ligjet për të rregulluar sfera të caktuara, jo kujt i tekët, por Qeveria i bën detyrimisht, mirëpo bëjnë edhe deputet, u përmend këtu. Kështu që nuk po shkoj më tutje, u intrigova se çuditshëm po më vjen pse deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk po dinë që sot nuk mund të me bëjnë propozime, mund t' i votojë ose jo. Edhe një herë po ju propozoj, zoti Kryetar, për me t' iu bërë një seminar, ta thërrasim dikën që u shpjegon procedurat se qysh bëhen ligjet, pse bëhen ligjet e tjera, e tjera, e tjera. faleminderit!

Diskutim i bashkëngjitur:

FLORA BROVINA: Programi i punës së Kuvendit për vitin 2010 të plotësohet edhe me këto tema:

1. Propozim-ndryshimi i Ligjit për zgjedhjet lokale, i hartuar dhe i dorëzuar në maj 2009 dhe i nënshkruar nga 83 deputetë;
2. Ligji për partitë politike;
3. Programi aksionar për barazi gjinore (i dorëzuar kaherë në Kuvend).

KRYETARI: Unë mendoj që janë organizuar mjaft seminare për këto çështje. Edhe një herë ligjet që i ka lexuar shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramë Buja, janë ligjet që me prioritet dhe në rend të parë kërkohet nga Qeveria që këto ligje t' i sjell, mundësisht para qershorit të këtij viti, për shkak se shumica e tyre nëse jo krejt janë përmendur edhe në Raportin e progresit të vitit të kaluar. Edhe pse ligji i parafundit që është në atë listë që ka të bëjë si Ligj për përgjimin e telekomunikimit bie ndesh me Kushtetutën dhe unë mendoj që, nuk di sa mund të bëhet ky ligj pa e ndryshuar nenin e Kushtetutës ku garantohet privatësia e banesës dhe e komunikimit dhe e Postës.

Dhe, konsideroj që debati është mbyllur. Nuk janë vetëm propozimet e Grupit Parlamentar, po dikush është dashur t' i thotë, mendoj që ka bërë mirë që i ka thënë, nuk janë vetëm ligjet të Grupit Parlamentar, janë ligjet që i duhen Kosovës, mendoj dhe janë përmendur në progresin e raportit dhe janë ligje që janë në progresin e raportit dhe janë ligje që janë në program, por që të jenë në procedura më të shpejtuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë për Propozim- programin e punës së Kuvendit për vitin 2010 që administrata ta hartojë programin mbi bazën e ndryshimeve të mundshme që janë diskutuar në Kuvend.

Votojmë tash:

Deputetë të pavarur, mos u lodhni shumë.

Konstatohet se me 56 vota “për”, 7 vota “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet Propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2010, me plotësim.

Vazhdojmë pikën e radhës.

- Propozim- plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2010

Komisionet parlamentare në pajtim me përfundimin e seancës plenare të mbajtur më 26 nëntor dhe 3 dhjetor 2009, kanë shqyrtuar Propozim- planin e veprimit të Kuvendit dhe rekomandimet e tyre ia kanë parashtruar Komisionit për Integritet Evropian.

Komisioni për Integritet Evropian ka rihartuar propozim planin e veprimit dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Integritet Evropian, deputeten Zylfije Hundozi, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë planin e veprimit.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotërinj ministra,

Zotërinj deputetë,

Menjëherë pas bërjes publike të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian në muajin tetor, Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjet e mbajtura me përfaqësuesin e Komisionit Evropian, zotëri Kaldun Sino, si edhe zëvendëskryeministrin, dëgjim publik me shoqërimin civil dhe në punëtorinë dy ditore me ç’ rast u diskutua për gjetje të Raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2009, si dhe për rrugët të cilat Kosova duhet të ndjekë që sa më shpejtë të integrohet në Bashkimin Evropian. Pas debateve dhe propozimeve për punën e mëtejme nga këto takime, Komisioni për Integritet Evropian i ka identifikuar sfidat për institucionet e Kosovës dhe në bazë të tyre ka hartuar një plan të veprimit në të cilin do të përfshihen të gjitha trupat e Kuvendit me qëllim të përmirësimit të këtyre sfidave.

Drafti i këtij plani të veprimit është shqyrtuar në seancën plenare, më 26 nëntor dhe 3 dhjetor. Në ndërkohë të gjitha komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar draftin e këtij plani të veprimit dhe i kanë dhënë propozimet sa i përket fushë veprimtarisë së secilit komision të cilat janë inkorporuar tash në draftin e ri dhe të cilin deputetët e kanë marrë që një kohë.

Në dallim nga viti i kaluar zbatimi i planit të veprimit do të udhëhiqet nga kryetari i Kuvendit të cilit komisionet do t’i raportojnë për zbatueshmërinë e tij, ndërsa Komisioni për Integritet Evropian do t’i raportojë çdo tre muaj seancës plenare.

Institucionet e Kosovës e kanë shprehur qartë vullnetin e tyre për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Sivjet para vetit i kemi edhe sfidat konkrete siç është liberalizimi i vizave si një hap fillestar, i cili nuk do të na le para fqinjëve tanë dhe të na izolojë nga

shtetet e Bashkimit Evropian, me të cilat komunikimi i qytetarëve tanë është më se i domosdoshëm për përparimin e jetës së tyre.

Prandaj, angazhimi i shtuar i të gjitha trupave të Kuvendit në procesin e integritimeve evropiane konkretisht duke e zbatuar këtë plan të veprimit që është sot para jush, do të mundësojë që të shtohen aktivitetet ligjvënës dhe mbikëqyrës ndaj ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura.

Duke vlerësuar se Kuvendi i Kosovës duhet të shprehë qëndrimin e vet ndaj konstatimeve në raportin e progresit dhe duke u nisur nga ajo se rruga e ardhshme e Kosovës drejt të ardhmes evropiane varet nga udhëheqësia sot e Kuvendi i Kosovës është institucioni më i lartë i këtij vendi, Komisioni për Integritime Evropiane rekomandon shqyrtimin dhe miratimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritimin evropianë.

Unë do t'i lexoj rekomandimet e Komisionit të cilat i keni edhe ju.

Kërkohe mbështetje nga të gjitha trupat e Kuvendit për forcimin e mëtejshëm të agjendës evropiane në Kuvend duke e zbatuar në plotësi obligimet nga plani i veprimit. Për përmbushjen e aktiviteteve të parapara në planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës, kërkohe nga të gjitha komisionet parlamentare të përfshijnë në agjendën e takimeve të tyre të rregullta pikën e veçantë të rendit të ditës, agjenda evropiane, ku do t'i shqyrtojnë sfidat e identifikuar në Raportin e progresit për vitin 2009 dhe veprimet në planin e veprimit.

Informacionet e mbledhura nga komisionet parlamentare, t'i dërgohen Kryesisë dhe Komisionit për Integritime Evropiane.

Komisioni për Integritime Evropiane të ngarkohet të përgatisë raporte të rregullta me rekomandime për zbatimin e planit të veprimit të cilat ia dorëzon për shqyrtim seancës plenare për çdo tre muaj.

Gjatë shqyrtimit dhe miratimit të agjendës legislative për vitin 2010, Kuvendi do të marrë parasysh të gjeturat rreth mungesës së kuadrit ligjor në raportin e progresit për Kosovën për vitin 2009 çka edhe u debatua më herët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

A do fjalën ndonjë kryetar tjetër i komisioneve, nuk do. Shefat e grupeve parlamentare a e donë fjalën? Do të thotë pajtoheni me këtë plan. Atëherë shkojmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miraton Planin e veprimit të Komisionit për Integritime.

Vazhdojmë. Pika e dhjetë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina**

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitën e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar propozim -vendimin e Qeverisë për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina. Sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet UNICEF-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në seancë plenare.

Ftoj, deputeti s'është këtu. Ministër a ke nevojë? Mirë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:
Konstatoj se me 46 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë për lejimin e pagesës për furnizim me vaksina sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet UNICEF-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Dhe, në fund:

- Propozimet e grupeve parlamentare për Integrim dhe të SLS-së për emërimin e deputetëve për anëtarë të komisioneve parlamentare

Në pajtim me rekomandim e Kryesisë së Kuvendit, Grupit Parlamentar për Integrim dhe Grupi Parlamentar i SLS-së, kanë bërë propozimin për emërimin e deputetëve për anëtarë të komisioneve parlamentare.

Propozimet e grupeve parlamentare u janë shpërndarë të gjithë deputetëve.

Lus deputetët që me një votim formal të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar për Integrim dhe të Grupit Parlamentar të SLS-së.

Kush është “për”, faleminderit! Shumica absolute “për”. “Kundër”, a ka? Nuk ka. Faleminderit!

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës